

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS  
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS

# DIALOGU KOSOVË - SERBI

(DOKUMENTE)



PRISHTINË  
2020

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS  
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS

# DIALOGU KOSOVË-SERBI

(Dilemat dhe kundërthëniet)



KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS  
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS

# THE DIALOGUE KOSOVA-SERBIA

(Dilemmas and contradictions)

Approved for publication at the meeting of the Presidency of the Academy,  
held on 28<sup>th</sup> May, 2020.



AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS  
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS

# DIALOGU KOSOVË-SERBI

(Dilemat dhe kundërthëniet)

U miratua për botim në mbledhjen e Kryesisë së Akademisë,  
mbajtur më 28 maj 2020.



Copyright © ASHAK

## MBI DIALOGUN SHTETËROR KOSOVË-SERBI

### Mbi kontekstin e dialogut

Republika e Kosovës, që nga shpallja e pavarësisë, të themelimit dhe të konsolidimit të institucioneve demokratike, të njohjes ndërkombëtare nga shumica e shteteve anëtare të OKB-së, të anëtarësimit në organizata të rëndësishme ndërkombëtare; krahas procesit të demokratizimit të brendshëm, përgjatë kësaj periudhe, në kuadër të fuqizimit të integritetit të saj ndërkombëtar, ka zhvilluar edhe procesin e dialogut me Serbinë, si mundësi për të mënjanuar pengesat dhe problemet në shumë fusha, me qëllim të përmirësimit të jetës së qytetarëve dhe të përsheptimit të procesit të integriteteve euro-atlantike.

Megjithatë, dihet mirëfilli se Republika e Kosovës, në procesin e dialogut ndërshtetëror me Serbinë ka hyrë nën kuadër të zbatimit të obligimeve të pranura ndërkombëtare konform Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, A/RES/64/298 të datës 9 shtator 2010, e cila njehë mendimin këshillues të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mbi përputhshmërinë e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës me të Drejtën Ndërkombëtare (*Ligjshmëria e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës më 22 korrik 2010*). Bashkimi Evropian ia arriti që të ndikojë në Asamblesë të Përgjithshme të OKB-së që në të njëjtën Rezolutë të përfshijë kërkesën që BE-ja të lehtësojë negociatat midis Kosovës dhe Serbisë për të normalizuar marrëdhëniet midis tyre dhe t'i ndihmojë ato që të arrijnë përparim në rrugën e tyre drejt anëtarësimit në BE.

Në këtë kuadër, Republika e Kosovës, si shtet i pavarur, sovran, i njohur ndërkombëtarisht, si subjektivitet ndërkombëtar, e ka zhvilluar procesin e dialogut nga viti 2011 me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian dhe në koordinim me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Fillimisht, dialogu ishte i përqendruar në masat teknike, për të lehtësuar lëvizjen e mallrave dhe njerëzve, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së jetës. Në vitin 2012, bisedimet përparuan në nivel politik, me takime të udhëheqësve më të lartë të të dy vendeve.<sup>i</sup> Ndërkohë, janë arritur mbi tridhjetë marrëveshje për fusha të ndryshme të interesit, ndërsa vëmendja dhe mbështetja ndërkombëtare për procesin e dialogut nuk ka munguar. Ka munguar, në shumë raste, vullneti për zbatimin e tyre nga pala serbe, por jo edhe dëshira nga pala kosovare që dialogu të marrë epilogun me njohjen e Kosovës nga ana e Serbisë.

Mbi këtë bazë, u shtuan pritjet dhe zërat në dy anët e kufirit kur dy vite më parë, Bashkimi Evropian nxori Strategjinë për Zgjerim (*6 shkurt 2018*)<sup>ii</sup>, në të cilën

përcaktohet pos tjerash, edhe obligimi specifik i Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë për sa i përket normalizimit efektiv dhe gjithëpërfshirës të marrëdhënieve Prishtinë-Beograd me një marrëveshje juridikisht të obligueshme.

Tani dy vite pas, kryefjala e udhëheqësve të institucioneve të Kosovës, si kurrë më parë, është nevoja e zhvillimit të dialogut dhe mundësisht arritja e një marrëveshje përfundimtare, gjithëpërfshirëse dhe ligjërish të detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.

Ne vlerësojmë se vëmendja e shtuar e bashkësisë ndërkombëtare, veçmas të SHBA-së për nxitjen e një marrëveshjeje mes Kosovës dhe Serbisë, duhet shfrytëzuar maksimalisht që të materializohet epilogu i dialogut disaveçar me njohje të ndërsjellë dhe nën kushtet e respektimit të kuadrit kushtetues dhe ligjor në fuqi.<sup>iii</sup>

Konsiderojmë se rruga e vetme e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me Serbinë është dialogu nën monitorimin e kujdesshëm të SHBA-së dhe BE-së, në mënyrë që një marrëveshje e tillë t'i sigurojë Kosovës anëtarësim në OKB dhe në organizatat e tjera ndërkombëtare, si dhe avancim konkret në rrugën e integritimit evropian.

### **Devijimet e dialogut**

Gjatë periudhës së deritanishme kanë ndodhur disa devijime nga kornizat e pritshmërisë të procesit të dialogut me Serbinë. Duke filluar nga faza fillestare e dialogut të ashtuquajtur teknik, pastaj dialogut politik për tema dhe çështje të cilat kanë qenë objekt i bisedimeve me palën serbe. Po ashtu, mungesa e unitetit dhe konsensusit të faktorit politik ka qenë evident, derisa kontestimi i marrëveshjeve të arrira në dialogun e Brukselit u provuan edhe në instancën më të lartë të interpretimit të Kushtetutës, në Gjykatën Kushtetuese. Gjithashtu, në mungesë të një platforme të përgjithshme dialoguese, në shumë raste u kontestua dhe u kundërshtua jo vetëm përmbajtja e marrëveshjeve të arritura në pikëpamje të dobive dhe dëmeve të tyre eventuale, por u kontestua edhe kompetenca e institucioneve dhe përfaqësuesve politikë që udhëhoqën fazat e caktuara të dialogut.

Kthesa më e madhe në devijimin e dialogut ka ndodhur pas nënshkrimit të marrëveshjes së vitit 2013, me të cilën Republika e Kosovës pranoi krijimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe. Kjo marrëveshje e nënshkruar në mes të dy kryeministrave të Kosovës dhe Serbisë do të duhej të ratifikohej në parlamentet e Kosovës dhe të Serbisë. Megjithëse Kosova e ratifikoi në parlament pa asnjë rezervë tekstin e marrëveshjes së 2013, Parlamenti Serb e votoi atë vetëm si Raport të Qeverisë për marrëveshjen e arritur, por nuk e ratifikoi si marrëveshje ndërkombëtare, derisa Gjykata Kushtetuese e Serbisë refuzoi që ta shqyrtojë kërkesën rreth kushtetutshmërisë së marrëveshjes, duke e konsideruar atë vetëm si akt politik, duke kontestuar në tërësi statusin e Kosovës si shtet.

Në anë tjetër, dialogu Kosovës Serbi shënoi devijimin më të madh pas nënshkrimit të marrëveshjes së dytë për asociacionin e komunave me shumicë serbe, respektivisht dokumentin e titulluar "Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore" të cilin Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës kishte konstatuar se i kishte shkelur disa parime dhe nene kushtetuese. Mos themelimi i asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë, sidomos pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese kishte bërë që dialogu të shënonte momentin më të madh të devijimit, duke i trazuar institucionet dhe bllokuar ecjen përpara në procesin e dialogut dhe në zbatimin e Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese që i kishte identifikuar dispozitat kushtetuese të cilat domosdo do të duhej të respektoheshin me rastin e Nxjerrjes së Dekretit qeveritar dhe hartimin e Statutit të Asociacionit të Komunave me shumicë serbe.<sup>iv</sup>

Qarqet politike dhe intelektuale të Kosovës, veçanërisht në periudhën e fundit trevjeçare, e kanë parë me shqetësim mungesën e ushtrimit aktiv të përgjegjësi kushtetuese të Qeverisë së Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Serbinë, veçanërisht të kompetencave kushtetuese edhe ligjore në zbatimin e orientimeve në fushën e politikës së jashtme.

Përfundimisht, koordinimi dhe bashkëveprimi në politikën e jashtme i institucioneve përgjegjëse kushtetuese të Republikës së Kosovës duhet të arrihet me çdo kusht, veçmas në rastin e përfaqësimit në dialogun me Serbinë. Në të kundërtën pamundësohet arritja e çdo marrëveshjeje eventuale dhe, për më keq, e bën të pazbatueshme çfarëdo marrëveshje që mund të arrihet.

Së këndejmi, ne bëjmë thirrje që të punohet bashkërisht nga të gjithë bartësit e përgjegjësive shtetërore, në mënyrë që faza përfundimtare e dialogut të zhvillohet nën kushtet e materializimit të plotë të interesit kombëtar dhe shtetëror të Kosovës, duke zbatuar Kushtetutën dhe aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese.

### **Moszbatimi i marrëveshjeve**

Ne gjithashtu vlerësojmë se, krahas stagnimit të procesit të dialogut në vitin 2017, nga mbi tridhjetë marrëveshje të arritura, për fusha e sektorë të ndryshëm, një numër i konsiderueshëm i tyre janë bllokuar së zbatuari nga pala serbe. Këto marrëveshje janë shumë të rëndësishme, sepse përmes tyre (p.sh. në fushën e kadastrës dhe njohjes së diplomave) do t'ju jepej përgjigje shumë sfidave me të cilat sot përballen interesat e shtetit dhe qytetarëve të të dy shteteve, sidomos të atyre shqiptarë.

Është evidente se marrëveshjet e arritura në përgjithësi janë karakterizuar nga zbatimi i dobët i tyre dhe, në të shumtën e rasteve, janë shkelur edhe afatet kohore të përcaktuara. Prandaj, paqartësitë dhe niveli i zbatimit të këtyre marrëveshjeve dhe krijimi i mekanizmave efektivë për zbatim duhet të adresohen përfundimisht në fazën e fundit të dialogut, e cila nuk duhet të cenojë rendin



kushtetues, integritetin territorial, karakterin unik dhe funksionimin e Republikës së Kosovës.

Ne konsiderojmë urgjente për institucionet kompetente të Republikës së Kosovës evidentimin e nivelit të zbatimit të marrëveshjeve të arritura dhe adresimin e përgjegjësisë së palës serbe për cilëndo shkelje dhe moskryerje të obligimeve të marra shtetërore.

Gjithashtu vlerësojmë se mos zbatimi i marrëveshjeve nga pala serbe lidhet ngushtë me mos njohjen e statusit të Kosovës nga Serbia, duke vënë në pikëpyetje shumë aspekte të procesit të dialogut, përfshirë edhe statusin kushtetues dhe vlefshmërinë e marrëveshjeve që janë nënshkruar.

Megjithatë Serbia ka qenë në vazhdimësi destruktive në procesin e dialogut, duke mos e njohur statusin e Kosovës, element ky shumë i rëndësishëm, edhe marrëveshjet e nënshkruara në dialogun Kosovë-Serbi kanë pasur një status të brishtë juridik. Asnjëra nga marrëveshjet e nënshkruara në procesin e dialogut, përveç ajo e vitit 2013, nuk ka kaluar nëpër procedurat kushtetuese, përfshirë edhe ratifikimin kushtetues, siç përcaktohet në nenin 18 dhe 19 të Kushtetutës. Që nga viti 2011 deri në vitin 2020, përveç marrëveshjes së nënshkruar në vitin 2013, Republika e Kosovës nuk e ka ratifikuar dhe nuk e ka shpallur në gazetën zyrtare asnjë marrëveshje tjetër.

Në kontekst të statusit të marrëveshjeve një element i rëndësishëm është edhe teksti i marrëveshjeve dhe titulli i tyre. Të gjitha marrëveshjet e nënshkruara në dialog, përveç asaj të nënshkruar në vitin 2013, nuk janë emërtuar si marrëveshje, por si: konkluzione, dakordime, konkluzat etj.<sup>v</sup> Ky element i bën edhe më të brishta në aspektin juridik të gjitha këto marrëveshje, në kuptim të rendit juridik të brendshëm në Kosovë, por edhe të Marrëveshjes së Vjenës për të Drejtën e Traktateve (1969).

### **Të metat dhe defektet juridike të marrëveshjeve të nënshkruara**

Krahas shkaqeve të tjera të mos zbatimit efikas apo zbatimit të pjesshëm të marrëveshjeve të nënshkruara, janë evidentuar edhe disa aspekte të cilat në thelb edhe e vënë në pikëpyetje cilësimin juridik të tyre si “marrëveshje”, si nga mungesa e përfilljes së aspekteve formalo-juridike, ashtu edhe në aspektet e tyre përmbajtësore.

Shumica e marrëveshjeve të nënshkruara, si të tilla, karakterizohen nga mungesa e qartësisë në natyrën e tyre juridike, qoftë në mungesën e formës së standardizuar juridike, qoftë në paqartësitë lidhur me autorësinë e tyre, apo nënshkrimin në shumë raste nga palët e pa autorizuar sipas legjislacionit në fuqi, apo qoftë në mungesën e mekanizmit zbatues të tyre.

Pavarësisht së Kuvendi i Kosovës kishte miratuar më 18 tetor 2012 "Rezolutën për normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë" në mbështetje të dialogut, dhe e cila thekson se rezultatet e dialogut duhet të jenë në pajtueshmëri me sovranitetin e Kosovës, subjektivitetin ndërkombëtar, integritetin territorial dhe rendin e brendshëm kushtetues të Kosovës, si dhe përcaktimin që marrëveshjet e arritura në dialogun politik duhet të ratifikohen në Kuvendin e Kosovës, kjo rezolutë u sfidua shpejt, sepse marrëveshjet që pasuan ndërkohë jo vetëm se nuk u ratifikuan në Kuvend (përveç marrëveshjes për normalizim, të datës 19 prill 2013), por edhe karakterizoheshin me segmente atipike për natyrën juridike të marrëveshjeve të nivelit të tillë ndërshtetëror.

Kjo kishte për pasojë, fillimisht, mungesën e qartësisë në zbatimin e tyre dhe mos marrjen e përgjegjësisë për zbatim si detyrim kontraktual, por si vullnet politik të cilin e kushtëzojnë faktorë e rrethana të tjera.

Thënë shkurt, niveli i zbatimit të marrëveshjeve të nënshkruara, fatkeqësisht përcaktohej më shumë nga vullneti politik, se sa nga detyrimi kontraktual i palëve nënshkruese për zbatim.

Për sa i përket Republikës së Kosovës, çështjet që lidhen me marrëveshjet e arritura me tiparet atipike, të cilat, siç thamë më lartë, nuk janë të natyrshme në veprimtarinë e vendosjes së marrëdhënieve kontraktuale më shtete të tjera apo me organizata ndërkombëtare, duhet parë edhe në dritën e formave të bashkëpunimit ndërkombëtarë të rregulluar me ligjin në fuqi për marrëveshjet ndërkombëtare.

Pra, përkundër që të gjitha marrëveshjet e arritura mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, me përjashtimin e cekur më sipër, nuk janë as "Marrëveshje ndërkombëtare" e as "Marrëveshje për bashkëpunim ndër-institucional", si dy format kryesore të bashkëpunimit ndërkombëtar të Kosovës, ato megjithatë kanë prodhuar rezultate konkrete.

Megjithatë, asnjëra nga këto marrëveshje nuk iu përmbahet parimeve të ligjit të lartpërmendur, për çka edhe natyra e tyre konsiderohet komplekse, sepse as nuk janë ratifikuar në Kuvend si marrëveshje ndërkombëtare, por as edhe nuk kanë përfillur procedurat e nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit ndër-institucional, të cilat rëndom ose zbatojnë një marrëveshje ndërkombëtare, ose janë në karakterit teknik.

Siç dihet, në parim, përmbajtja e një marrëveshjeje e kushtëzon edhe titullin e saj, nëse do të konsiderohet "Marrëveshje ndërkombëtare" apo "Marrëveshje për bashkëpunim ndër-institucional", e si rrjedhojë edhe procedurat e realizimit të saj. Megjithatë, institucionet kompetente të Republikës së Kosovës, nuk kanë një standard unik, jo vetëm të shkruar por edhe praktik për të konstatuar dhe

verifikuar se në cilat raste një marrëveshje është “Marrëveshje ndërkombëtare” apo “Marrëveshje për bashkëpunim ndër-institucional”.

Kjo ka shërbyer, me rastin e lidhjes së këtyre marrëveshjeve, edhe si mundësi për veprim më pak të kufizuar të institucioneve përgjegjëse, që këto marrëveshje nuk i janë përmbajtur as formës së bashkëpunimit ndërkombëtar të rregulluar me ligj, e as përmbajtjes së këtij bashkëpunimi, prandaj edhe janë të pritshme pasojat e moszbatimit të tyre nga palët nënshkruese, në mungesë të përligjies së duhur të obligimeve kontaktuale që burojnë dhe derivojnë prej këtyre marrëveshjeve.

### **Asociacioni i komunave me shumicë serbe**

Institucionet e Republikës duhet të jenë të gatshme që krahas përballjes me pandeminë si prioritet i parë, të kenë njëkohësisht prioritet politikën e jashtme dhe zgjidhjen përfundimtare të problemeve me Serbinë, si dhe çështjet e grumbulluara të brendshme, luftën kundër krimit dhe korrupsionit dhe zhvillimin ekonomik, për të siguruar jetë më të dinjitetshme për popullin e Kosovës.

Dialogu me Serbinë duhet të merret më me seriozitet, duke mos e lëshuar rastin që nuk vjen shpesh, kur edhe SHBA, edhe Mbretëria e Bashkuar edhe Bashkimi Evropian e konsiderojnë arritjen e një marrëveshjeje paqësore midis Kosovës dhe Serbisë të rëndësishme për të përmbyllur kapitullin e trazirave në Ballkan dhe për të garantuar integritetin euroatlantik të tij.<sup>vi</sup>

Përkundër faktit se me të drejtë mund të konsiderohet se nënshkrimi i Marrëveshjes së Parë të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, më 19 prill 2013 nga Kryeministri i Republikës së Kosovës dhe Kryeministri i Republikës së Serbisë e ka devijuar rrjedhën e duhur të bisedimeve të filluara me Serbinë, ratifikimi i saj nga Kuvendi i Republikës së Kosovës si Marrëveshje ndërkombëtare sipas Kushtetutës, me votën e dy të tretave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, na obligon si shtet serioz që e respekton të drejtën ndërkombëtare, ta zbatojmë atë. Pa angazhim serioz në përmbushjen e obligimeve të ndërmarra ndërkombëtare, ne si një shtet i ri, ende jashtë organizmave ndërkombëtare, nuk mund ta hapim shtegun për integritet evroatlantike. Sidomos, duhet pasur kujdes, se megjithëse Marrëveshja e parë ishte e udhëhequr, lehtësuar dhe ndërmjetësuar nga BE, mbështetja e vazhdueshme e SHBA-së prapa skenës ishte thelbësore.<sup>vii</sup> Në këtë rrugëtim, të gjitha institucionet e Kosovës duhet të jenë konstruktive, por sidomos Qeveria duhet të dëshmojë udhëheqje, vizion dhe guxim, e para së gjithash aftësi për të siguruar konsensus të gjerë dhe mbarë shoqëror.

Qeveria e Kosovës dhe të gjitha institucionet e tjera tashmë janë të liruara nga frika dhe ankthi që i ka përcjellë gjeneratat e mëhershme për çështjen e pazgjidhur të statusit. Shtetësia e Kosovës është e pakthyeshme dhe statusi i saj si Republikë e pavarur tashmë është zgjidhur dhe se SHBA-ja si partner yni strategjik,

së bashku me shtetet e KUINT-it, pa ekuivoke, në secilin rast e rithekson këtë realitet.<sup>viii</sup>

Marrëveshja e parë e vitit 2013, me gjithë të metat që i ka, si në përmbajtje, ku çojnë peshë sidomos disa nga parimet për asociacionin e komunave me shumicë serbe dhe diskriminimi etnik, madje i ndaluar edhe me instrumente evropiane për të drejta të njeriut, ashtu edhe në procesin jotransparent dhe jogjithpërfshirës për arritjen e saj, ka siguruar edhe përparim të dukshëm në shtrirjen e sovranitetit të shtetit tonë në tërë territorin e vet. Me këtë Marrëveshje janë shpërbërë organizatat paralele të Serbisë që deri atëherë kanë operuar në Kosovë, janë institucionalizuar policia dhe gjyqësori i Republikës së Kosovës në tërë territorin e vet dhe Kushtetuta dhe ligjet e Kosovës janë të vetmet që zbatohen edhe në komunitet me shumicë serbe<sup>ix</sup>. Më tutje, me atë Marrëveshje jo të përkryer organizohen zgjedhje në bazë të ligjit tonë zgjedhor, Dogana e Kosovës funksionon në kufi me Serbinë dhe regjistri civil i Kosovës është rikrijuar plotësisht. Tashmë, Kosova merr pjesë edhe në organizma ekonomik rajonale pavarësisht dhe, edhe pse ende me fusnotë, ka lidhur marrëdhënie kontraktuale me Bashkimin Evropian me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes për Stabilizim Asociim dhe së fundi, arriti që ta fitojë të drejtën që të shtrijë sovranitetin e vet energjetik në tërë territorin e saj.

Fatkeqësisht kanë mbetur edhe shumë pengesa, po bëhen edhe më tutje shumë obstrukcione nga ana e shtetit serb, që e bëjnë Republikën tonë ende jo plotësisht funksionale dhe jopjesëmarrëse në institucione të rëndësishme ndërkombëtare. Përkundër faktit se me Marrëveshjen e vitit 2013 palët ishin dakorduar se nuk do ta pengonin njëra-tjetrën në procesin e integritimeve evropiane, Serbia është edhe sot pengesë për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës, që është “paradhomë” drejt integritimeve evropiane. Si rrjedhojë, qytetarët tanë nuk janë nën juridiksionin e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut, Kosova nuk është palë e rreth 200 konventave dhe traktateve të Këshillit të Evropës që e bëjnë jetën e qytetarëve tanë shumë të vështirë, e as sot e kësaj dite, qytetarët tanë nuk e kanë fituar të drejtën e lëvizjes së lirë në zonën e Shengenit. Përkundër Marrëveshjes aq të dhimbshme të vitit 2013, e që prek në çështjet e brendshme të shtetit tonë, Serbia pareshtur është angazhuar që Kosova të mos mund të anëtarësohet as në Interpol që do të ishte në interes edhe të Kosovës, por edhe të vet Interpolit si organizatë, dhe as në UNESCO, ku angazhimi agresiv i Serbisë ndikoi që Kosova të dështojë të anëtarësohet.

Izolimi i Kosovës, pamundësia e anëtarësimit në organizata ndërkombëtare, paperspektiva, mungesa e bashkëpunimit me botën, mbyllja e potencialit të Kosovës për zhvillim dhe përfundimisht mosrealizimi i aspiratës së shprehur në Kushtetutë për integritime euroatlantike, ka ndikuar që Kosova, përkundër pakënaqësive me Marrëveshjen e vitit 2013, të mos rezistojë dhe ta ratifikojë atë

në Kuvend. Dykuptimësia e qëllimshme e vetë parimeve të Marrëveshjes së vitit 2013, jo vetëm në përmbajtje, por edhe në formë, sado frustruese, e mundësoi që me manovra kreative, të dy palët ta pranojnë marrëveshjen si të detyrueshme. Derisa Kosova e kishte ratifikuar sipas Kushtetutës me 2/3 e votave të të gjithë deputetëve si Ligj për Ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të Parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, Serbia e kishte votuar me shumicë votash si Raport të Qeverisë për arritjen e Marrëveshjes së Parë të Parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve. Akrobacionet e këtilla të miratimit të marrëveshjes nga ana e Serbisë, e bënë atë megjithatë juridikisht të detyrueshme edhe për Serbinë përmes “karotës” së BE-së – caktimit të datës për çeljen e negociatave për anëtarësim në BE, “karotë” që fuqishëm dhe pa ekuivoke e përdorte dhe vazhdon ta përdorë Gjermania.<sup>x</sup> Për të qenë korrekt, dykuptimësia e Marrëveshjes, sidomos për sa i përket formës, më shumë se sa përmbajtjes, i konvenonte edhe vetë BE-së, që në përbërjen e vet edhe më tutje i kishte dhe vazhdon t’i ketë pesë shtete që nuk e njohin Kosovën si shtet.

Edhe pse “karota” për Kosovën nuk ishte aq e dukshme dhe me të drejtë opozita dhe publiku e kritikonin qeverinë për vazhdimin e negociatave, pas një periudhe heshtjeje për shkak të zgjedhjeve dhe përplasjeve politike tashmë të zakonshme tek ne për formimin e qeverisë, e në të njëjtën kohë edhe të zgjedhjeve në Serbi, në gusht të vitit 2015, dy vjet pas arritjes së Marrëveshjes së Parë, Kosova dhe Serbia arritën një marrëveshje të veçantë për Asociacionin e komunave me shumicë serbe, me të cilën në detaje ishte përcaktuar modeli dhe kompetencat e tij. Njësoj si edhe Marrëveshja e parë, edhe kjo e dyta përshkohej me dykuptimësi. Atmosfera e polarizuar politike që ishte edhe rrjedhojë e përplasjeve të egra politike në qeverinë që ishte formuar pas një krize të thellë politike bazuar në “paqartësitë” se si dhe kush do të mund ta formonte qeverinë, e kishin zënë vendin plotësisht të papërgatitur dhe pa asnjë platformë për dialogun e rëndësishëm për fatin dhe ardhmërinë e vendit. Nuk ekzistonte asnjë ekip i përgatitur, nuk kishte studim rreth propozimeve serbe. Madje, nuk ishte punuar asgjë e veçantë për tu përballur me planin rezervë serb katër pikësh, pjesë e propozuar e të cilit ishte regjioni autonom i katër komunave veriore me shumicë serbe dhe decentralizimi me kompetenca të zgjeruara të komunave me shumicë serbe në viset në jug të Kosovës, përfshirë eksterritorialitetin për monumentet dhe kishat ortodokse serbe.<sup>xi</sup> Madje, nuk ishin shfrytëzuar as mundësitë ekzistuese kushtetuese dhe ligjore të Kosovës të cilat ishin hartuar konform kërkesave të Pakos së Ahtisarit, e të cilat mund t’i akomodonin interesat e komunitetit joshumicë serb që ishin shumicë në komunat në veri dhe në disa komuna në jug të lbrit për Asociacionin. Ishte vetëm një cilësi, karakteristike e kësaj Marrëveshje të rëndësishme, të miratuar në formë dokumenti nga kryeministrat e atëhershëm të Kosovës dhe të Serbisë në takimin e kryesuar nga Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian për Çështje të Jashtme dhe Politika të

Sigurisë, e që e bënte të mundur edhe përmbushjen e obligimeve të dala nga dialogu, por edhe interesave të brendshme kushtetuese, e që me mjeshtri ishte përfshirë në këtë dokument për Asociacionin e Komunave me shumicë serbe. Ky obligimi për kontroll kushtetues kërkonte që dekreti qeveritar për formimin e Asociacionit të Komunave me shumicë serbe, si dhe Statuti i tij të shqyrtohej nga ana e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, si dhe secili amendamentim i mundshëm i tij, e që në mënyrë eksplicite pranohej nga pala serbe<sup>xii</sup>..

Shqetësimi i përgjithshëm për mundësinë që Marrëveshja e arritur për Dokumentin e “Asociacionit/Bashkësisë së komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore” të ishte kundërkushtetues, e nxitën Presidenten e Kosovës që të kërkonte interpretim nga Gjykata Kushtetuese. Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese<sup>xiii</sup> përcaktoi se Asociacioni i Komunave me shumicë serbe do të formohet siç e kishte paraparë Marrëveshja e Parë, e ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe e shpallur nga Presidentja e Republikës së Kosovës, por edhe se parimet e përfshira në dokumentin e dytë të vitit 2015 nuk ishin në tërësi në përputhshmëri me Kushtetutën. Me atë Aktgjykim, Gjykata kishte konstatuar se akti juridik i ardhshëm i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me të cilin do të themelohej Asociacioni i Komunave me shumicë serbe dhe Statuti që i implementon Parimet e Asociacionit, duhet të jenë në harmoni me dispozitat kushtetuese të identifikuara me Aktgjykim. Fatkeqësisht, për shkak të krizave të njëpasnjëshme politike në vend, përplasjeve partiake dhe rrëzimin e njëpasnjëshëm të qeverive, duke mos e përfunduar mandatin asnjëra prej tyre që nga ajo kohë, si dhe për shkak të institucioneve jostabile shtetërore, asnjëherë nuk u punua që obligimet e marra ndërkombëtare të mos përmbushen dhe Aktgjykimi i Gjykatës kushtetuese të mos zbatohet. Kjo gjë nxiti rritjen e apetiteve të rrezikshme të Serbisë ndaj territorit të Kosovës dhe Kosova filloi të mos merrej seriozisht as nga partnerët e saj strategjikë. Për më shumë, plani i munguar i Kosovës për ballafaqim me Serbinë, i mundësoi Serbisë që të përfitojë interesimin e disa zyrtarëve të BE-së për këmbim të territoreve me Kosovën dhe të ripërtërijë aktivitetin e shteteve të aleancës së të painkuadruarve, duke bërë fushatë ekstreme agresive për deligjimitetin e shtetësisë së Kosovës dhe nxitjen e shteteve për tërheqjen e njohjeve të Kosovës.

Është momenti i fundit që të ndërtohet strategjia për t’i prirë dialogut me qëllim të përmbylljes së tij me Serbinë me një Marrëveshje paqësore që do të ruajë sovranitetin shtetëror dhe territorial të Kosovës, të ndërmjetësuar nga SHBA-ja, shtetet e KUINT-it dhe BE-ja. Për të realizuar këtë qëllim, Kosova duhet të dëshmojë se do të përmbushë obligimet ndërkombëtare të cilat i ka marrë përsipër deri më tani, t’i zbatojë vendimet e Gjykatës Kushtetuese, që të gjitha, për t’u trajtuar si shtet ku sundon ligji dhe të prezantojë dhe të respektojë gjithë legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e monumenteve të pronës së Kishës ortodokse

serbe, në mënyrë që të mos lejohet që Kosova të hyjë në ujërat e turbullta të negociimit të mundshëm të eksterritorialitetit të tyre.

### Tejkalimi i “status quo-s”

Ne vlerësojmë jo vetëm të panevojshme por edhe të dëmshme vazhdimin e gjendjes ekzistuese të procesit të bllokuar të dialogut me Serbinë. Është e domosdoshme që Republika e Kosovës, krahas përgatitjes për fazën e fundit të këtij dialogu, të ushtrojë të gjitha kompetencat për të dëshmuar funksionalitetin e saj si shtet serioz në raport me subjektet e së drejtës ndërkombëtare.

Aktualisht, në përballjen me ofensivën diplomatike të Serbisë, për ta prezantuar Kosovën si shtet të paaftë e jo të suksesshëm dhe duke lobuar për ç’njohje të saj, vetëm “status quoja”-ja e tanishme nuk iu konvenon interesave strategjike të Republikës së Kosovës, ndërsa diskursi politik i kohëve të fundit i përgjegjësve të institucioneve tona kushtetuese lidhur me procesin e dialogut është me pasoja politike dhe diplomatike për Republikën e Kosovës dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë iu përshtatet interesave të Serbisë.

Gjithashtu konsiderojmë se, pavarësisht nga fakti se procesi i dialogut të Brukselit është kushtëzuar nga faktorë të ndryshëm, themelimi i Asociacionit përbën obligim ligjor ndërkombëtar.

Përderisa është në fuqi, Marrëveshja e parë ndërkombëtare e parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë (datë 19 prill 2013), e cila është ratifikuar në formën e ligjit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, themelimi i këtij Asociacioni është detyrim ligjor dhe me pasoja juridike.

Mos kontrollimi i themelimit të Asociacionit ekskluzivisht nga Qeveria e Republikës së Kosovës mund të prodhojë situatën kur ky asociacion do të negociohet në marrëveshjen përfundimtare dhe si i tillë të dalë jashtë asaj që lejon rendi juridik dhe kushtetues i Kosovës. Kjo mund të ndodhë për shkak të presionit serb, me pretekstin e dështimit për themelim të këtij asociacioni nga Republika e Kosovës.

Së këndejmi, ne konsiderojmë se institucionet e Kosovës duhet ta themelojnë Asociacionin në pajtim të plotë me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese (Aktgjykimin në rastin nr. K0130/15) dhe me kuadrin ligjor në fuqi, duke ruajtur karakterin unitar të Republikës së Kosovës dhe funksionalitetin e shtetit dhe përfundimisht t’ia pamundësojnë palës tjetër sabotimin dhe kushtëzimin e mëtejshëm të dialogut.

Në të njëjtën kohë, Kosova duhet të ngulë këmbë që Serbia të zbatojë të gjitha Marrëveshjet e pazbatuara nga Procesi i dialogut teknik të viteve 2011/2012.

Moszbatimi i tyre jo vetëm që e vështirësoi jetën e qytetarëve të Kosovës, por edhe të shqiptarëve që jetojnë në luginën e Preshevës.

### “Vijat e kuqe” në procesin e dialogut

Ne vlerësojmë se të ashtuquajturat “vija të kuqe” janë të domosdoshme dhe të padiskutueshme, në kuadër të procesit të dialogut me Serbinë.

Republika e Kosovës duhet ta zhvillojë fazën vijuese përfundimtare të dialogut me Republikën e Serbisë brenda kuadrit kushtetues dhe ligjor në fuqi. Kjo nënkupton se sovraniteti dhe integriteti territorial i Republikës së Kosovës është i pacenueshëm, i patjetërsueshëm dhe i pandashëm, siç përcaktohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Po ashtu, rregullimi i brendshëm i vendit është kompetencë sovrane e institucioneve shtetërore, e rregulluar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ndërsa Plani i Ahtisarit për zbatimin e të cilit Kosova është zotuar në Deklaratën e Pavarësisë, i integruar në Kushtetutë, është platforma e vetme për rregullimin e të drejtave dhe garancive për komunitetet dhe ofron gamë të gjerë të drejtash të veçanta për komunitetin serb, si pjesëmarrës në qeverisje, duke tejkaluar standardet ndërkombëtare për të drejtat e minoriteteve dhe për negociimin e të cilës Serbia intensivisht ka negociuar.

Republika e Kosovës, gjithashtu, nuk mund të lejojë as të pranojë të negociohet çfarëdo ndryshimi të kufijve midis Kosovës dhe Serbisë, në formë të “korigjimit”, “shkëmbimit” dhe “ndarjes” së Kosovës, sepse kjo do të kishte pasoja të mëdha dhe të pariparueshme për shtetësinë dhe subjektivitetin ndërkombëtarë të Kosovës, veçanërisht kur dihet se Dokumenti i Presidentit Marti Ahtisari dhe dokumentet e tjera, si: Kushtetuta e KSA e Kosovës e vitit 1974, Deklarata e Pavarësisë e 17 shkurtit 2008 dhe Kushtetuta e Republikës e vitit 2008 i referohen tërësisë aktuale territoriale në të cilën janë të definuar kufijtë e Kosovës, pa i theksuar këtu pasojat eventuale në nivel rajonal dhe më gjerë.

Gjithashtu, ne konsiderojmë se Republika e Kosovës duhet të ketë disa “vija të kuqe” në raport me këtë proces dhe atë:

1. Të ruhet integriteti territorial i Republikës së Kosovës, në bazë të kufijve të njohur ndërkombëtarisht, sipas Deklaratës së Pavarësisë 2008;
2. Të ruhet rendi kushtetues, duke mos lejuar kompromise, të cilat shkojnë përtej asaj që është dhënë nga Plani Ahtisari, i inkorporuar tashmë në rendin kushtetues;
3. Të mos lejohet krijimi i mekanizmave shtesë kushtetues, derisa ekzistojnë mekanizma në nivel qendror dhe lokal të pjesëmarrjes në përpjesëtim të pushtetit për serbët dhe për komunitetet e tjera jo-shumicë, që shpesh e bëjnë vendim-marrjen në Kosovë tejet të vështirë.



4. Të mos lejohet që asociacioni i komunave me shumicë serbe të krijohet jashtë kornizës kushtetuese dhe ligjore që është në fuqi në Republikën e Kosovës;
5. Të gjitha zgjidhjet e tjera në dialog të bëhen duke u ruajtur Pavarësia e Kosovës e vitit 2008, si dhe rendi kushtetues dhe ligjor, si dhe të mos lejohet pandëshkueshmëria për gjenocid, krime të luftës dhe krime kundër njerëzimit.

### **Elementet e një marrëveshjeje përfundimtare**

Të gjitha çështjet e hapura me Serbinë duhet të jenë përmbajtja e një marrëveshjeje eventuale përfundimtare me Serbinë.

Konsiderojmë se disa nga çështjet kryesore, të cilat do të duhej të zgjidheshin përmes marrëveshjes përfundimtare janë: zbardhja e fatit të personave të pagjetur, adresimi i përgjegjësisë penale për krime të luftës, dëmshpërblimet e luftës, kompensimi i viktimave të luftës, kthimi i të mirave materiale, kursimeve dhe pensioneve për qytetarët e Kosovës, kthimi i pronës së Kosovës dhe qytetarëve të saj etj.

Po ashtu, në marrëveshjen përfundimtare duhet të përfshihen obligimet e zbatimit të plotë të marrëveshjeve të arritura në fazën teknike të dialogut të negociuar të zhvilluar me ndërmjetësim të BE-së.

Fazën vijuese përfundimtare të dialogut, Republika e Kosovës duhet ta shfrytëzoj si mundësi të papërsëritshme për avancimin e pozitës kushtetuese dhe të të drejtave legjitime të shqiptarëve të Preshevës, Bujanocit dhe të Medvegjës, paralelisht me ato të serbëve të Kosovës, mbi bazën e parimit të reciprocitetit.

Mbi këtë bazë, ne konsiderojmë se marrëveshja përfundimtare duhet të nënshkruhet në kapacitete të barabarta, ku Serbia e njeh Kosovën si shtet kurse marrëveshja finale të nënshkruhet si traktat, në përputhje me Konventën e Vjenës për të Drejtën e Traktateve të vitit 1969. Në të kundërtën, marrëveshja përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë nuk ka ndonjë vlerë juridike.

Ndërkaq, disa nga elementet që duhet t'i përmbajë marrëveshja përfundimtare në mes Kosovës dhe Serbisë mund të jenë:

1. Lidhja e marrëveshjes duke pasur parasysh kapacitetet e plota shtetërore të të dyja palëve;
2. Statusi i marrëveshjes të jetë i atillë, në kapacitetin e traktatit ndërkombëtar, sipas Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve;
3. Në marrëveshjen përfundimtare të kërkohet revokimi i Rezolutës 1244 të KS të OKB-së dhe të përcaktohet anëtarësimi i Kosovës në mënyrë direkte në OKB;

4. Në marrëveshje të kërkohet që çështja e personave të zhdukur të trajtohet në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare;
5. Të kërkohet nga Serbia që të hapë të gjitha dosjet me informacione për personat e zhdukur dhe të zbulojë vendndodhjen e të gjithë personave që e kanë humbur jetën gjatë luftës dhe trupat e të cilëve janë zhvendosur për të humbur gjurmët e krimeve dhe për realizimin e këtij obligimi, BE si ndërmjetësues të sigurojë një emisar special;
6. Të hapet procesi i rikthimit në shtëpi të tyre të personave të zhvendosur, sidomos në pjesën veriore të Kosovës, kur shqiptarët nuk ndjehen të sigurt të kthehen pa një marrëveshje përfundimtare, por edhe të të zhvendosurve qoftë nga Serbia në Kosovë, ashtu edhe nga Kosova në Serbi;
7. Të krijohet një grup punues nga përfaqësues të të dy shteteve për reparacione të dëmeve shtetërore të shkaktuara nga regjimi i Millosheviqit;
8. Në marrëveshjen përfundimtare të saktësohet obligimi i Serbisë që të mos e pengojë anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare dhe në BE;
9. Në marrëveshjen përfundimtare të përcaktohet statusi i të gjitha marrëveshjeve që janë lidhur deri më tani në procesin e dialogut Kosovë-Serbi dhe ato të inkorporohen në marrëveshjen përfundimtare;
10. Në marrëveshjen përfundimtare duhet të përcaktohet obligimi për tu bërë demarkacioni i kufirit midis Kosovës dhe Serbisë, siç është rregulluar me Pakon e Ahtisaarit dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës;
11. Të krijohet një mekanizëm zbatues i marrëveshjes përfundimtare, në mënyrë që të ketë garanci që marrëveshja do të zbatohet;
12. Në marrëveshje duhet të ketë zotim të qartë se të dyja shtetet do ta ratifikojnë marrëveshjen në parlamentet e tyre.

#### **Uniteti politik dhe institucional për dialogun**

Ne konsiderojmë se në procesin e dialogut është i domosdoshëm konsensusi politik dhe institucional, në mënyrë që procesi i dialogut të përmyllet me sukses. Kjo nënkupton zhvillimin paraprak të dialogut politik ndër-institucional të të gjitha subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Është e domosdoshme, ndër të tjera, që pozita dhe opozita të gjejnë gjuhën e përbashkët të komunikimit dhe bashkëveprimit dhe të participojnë proporcionalisht me fuqinë e tyre politike, në arritjen e rezultateve, por edhe në marrjen përsipër të përgjegjësisë.

Në këtë kontekst, Republika e Kosovës duhet të krijojë mekanizmat e konsultimit dhe të përfaqësimit në dialog dhe ku do të përfshiheshin institucionet kushtetuese si presidenti dhe kryeministri, si dhe përfaqësuesit e subjekteve politike të pozitës dhe opozitës. Pjesë e këtij ekipi do të duhej të ishin edhe

përfaqësues nga shoqëria civile dhe të institucioneve shkencore dhe profesionale, si dhe një numër ekspertësh të fushave të ndryshme.

Ne konsiderojmë se uniteti politik, kombëtar e institucional, për një marrëveshje të tillë përfundimtare me Serbinë duhet të konfirmohet në referendum si dhe njëzëri të ratifikohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

### Rekomandime

1. Të inkurajohen liderët institucionalë që të shfrytëzojnë momentumin politik dhe mbështetjen e aleatëve strategjikë dhe të angazhohen në përpjekjet për arritjen e paqes, stabilitetit dhe prosperitetit përmes arritjes së marrëveshjes përfundimtare mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë;
2. Që institucionet në procesin e dialogut t'u japin përparësi interesave shtetërore si dhe të kujdesen që procesi të zhvillohet brenda kornizave kushtetuese dhe platformës shtetërore të dialogut;
3. Që të bëhet evidentimi nga institucionet kompetente të nivelit të zbatimit të marrëveshjeve të arritura deri më tani dhe të kërkohet nga palët ndërmjetësuese në dialog krijimi i mekanizmave zbatues të këtyre marrëveshjeve dhe të marrëveshjes eventuale përfundimtare;
4. Që themelimi i Asociacionit/Bashkësisë së komunave me shumicë serbe në Kosovë të bëhet në përputhje të plotë me Aktgjykimin në rastin nr. K0130/15 të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.
5. Që çfarëdo marrëveshje përfundimtare mes Republikës së Kosovës dhe të Republikës së Serbisë duhet të arrihet brenda kuadrit kushtetues dhe ligjor në fuqi, në mënyrë që sovraniteti dhe integriteti territorial i Republikës së Kosovës të mbetet i pacenueshëm, i patjetërsueshëm dhe i pandashëm, siç përcaktohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
6. Që Republika e Kosovës duhet ta shfrytëzojë fazën vijuese dhe përfundimtare të dialogut si mundësi për avancimin e pozitës kushtetuese dhe të të drejtave legjitime të shqiptarëve të Preshevës, Bujanocit dhe të Medvegjës, paralelisht me ato të serbëve të Kosovës, mbi parimin e reciprocitetit.
7. Që një marrëveshje eventuale përfundimtare me Serbinë duhet të konfirmohet në referendum si dhe të ratifikohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës.
8. Që Republika e Kosovës duhet ta zhvillojë fazën vijuese përfundimtare të dialogut në koordinim dhe bashkërendim të ngushtë me aleatët perëndimorë, SHBA-në dhe BE-në, në mënyrë që përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave kombëtare në këtë proces të jetë vijimësi e kontributit të partnerëve strategjikë, sikurse në fazën e luftës për liri, shtetëkrijimin dhe konsolidimin e tij, po ashtu edhe për paqen, sigurinë dhe stabilitetin rajonal.

- 
- i Martin Russell, "Serbia–Kosovo Relations Confrontation or Normalisation?" European Parliament Briefing, February 2019, [http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2019/635512/EPRS\\_BRI\(2019\)635512\\_EN.pdf](http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2019/635512/EPRS_BRI(2019)635512_EN.pdf) (accessed October 8, 2019).
- ii EC (2018) Strategy for the Western Balkans, 6 Feb 2018, [https://ec.europa.eu/commission/news/strategy-westernbalkans-2018-feb-06\\_en](https://ec.europa.eu/commission/news/strategy-westernbalkans-2018-feb-06_en)
- iii Ted R. Bromund and Daniel Kochis, "Six Key Priorities for U.S. Europe Policy in a Crucial Year," Heritage Foundation Issue Stefan Lehne, "Kosovo and Serbia: Toward a Normal Relationship" Carnegie Policy Outlook (2013)No. 5025, January 17, 2020, <https://www.heritage.org/europe/report/six-key-priorities-us-europe-policy-crucial-year>.
- iv Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, 'Aktgjykim në rastin KO 130/15', (23 dhjetor 2015)
- v Megjithatë, President i Serbisë, të gjitha marrëveshjeve të nënshkuara me përfaqësuesit e Kosovës para institucioneve ndërkombatëre dhe evropiane, madje edhe para publikut serb l emërton si marrëveshje. Shih p.sh. deklaratën e Presidentit Vucic për transmetuesin publik të Republikës së Serbisë: <https://www.rts.rs/page/stories/sr/story/9/Politika/2017461/Vučić%3A+Potpisani+sporazumi+u+Briselu%2C+formirana+Zajednica+srpskih+opština.html>
- vi Deklaratë e përbashkët e qeverive të Francës, Gjermanisë, Italisë, Mbretërisë së Bashkuar dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, 13 gusht 2019, <https://xk.usembassy.gov/joint-statement-by-the-governments-of-france-germany-italy-the-united-kingdom-and-the-united-states/>
- vii Lehne, S. (2013). Serbia-Kosovo Deal Should Boost the EU's Western Balkans Policy', Carnegie Europe, 13 April 2013.
- viii U.S. Relations With Kosovo BILATERAL RELATIONS FACT SHEET BUREAU OF EUROPEAN AND EURASIAN AFFAIRS OCTOBER 31, 20; 19
- ix European Commission, Staff Working document, Montenegro 2019 report, Accompanying the document Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions 2019, Communication on EU Enlargement Policy, 29 May 2019.
- x Lehne, S. (2012). *Kosovo and Serbia: Toward a normal relationship*. Carnegie Endowment for International Peace
- xii Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore, Pikat 2 dhe 22 në [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Asociacioni\\_perkthimi\\_shqip\\_-\\_final.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Asociacioni_perkthimi_shqip_-_final.pdf).
- xiii Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, 'Aktgjykim në rastin KO 130/15', (23 dhjetor 2015).



SHTOJCË  
MARRËVESHJET  
(DOKUMENTE)



**KONKLUZAT E DAKORDUARA 2 KORRIK****Librat amzë**

1. Palët, bashkërisht, do të bëjnë krejt çka është e mundshme, për të krijuar një regjistër civil plotësisht të besueshëm në Kosovë;
2. Do të formohet një "komitet i përbashkët" trepalësh të përbërë nga ekspertë të regjistrimit civil nga të dy palët dhe EULEX-i, ky i fundit vepron si kryesues, për të identifikuar zbrastësirat në librat amzë original të para vitit 1999 të cilat mungojnë;
3. EULEX-i do t'i vërtetojë kopjet e librave amzë nga Kosova, komunë pas komune, në konsultim me ekspertët nga të dyja palët sipas nevojës; EULEX-i do t'i procesojë kopjet e vërtetuara me qëllim që në Kosovë do të vendoset një regjistër plotësisht i besueshëm.
4. Sipas kërkesës, EULEX-i do të jetë i gatshëm të ofrojë informata të caktuara.



## KONKLUZAT E DAKORDUARA 2 KORRIK 2011

### Liria e lëvizjes

1. Qytetarët (me vendbanim të përhershëm) të të dyjave palëve duhet të kenë mundësi të udhëtojnë lirshëm brenda ose përmes territorit të njëra-tjetrës.
2. Secila palë do të zbatojë, sa më shpejt që është e zbatueshme në aspekt operativ, një sistem të kalimit të kufirit/kufirit administrativ të qytetarëve të palës tjetër me letërnjoftime;
3. Secila palë mund të zbatojë një sistem ku letërnjoftimet do të shoqërohen nga dokumente<sup>1</sup> me shkrim "hyrje-dalje" për personat nga pala tjetër të cilët dëshirojnë të kalojnë tranzit në një shtet të tretë.
4. Si zgjidhje kalimtare, secila palë do t'ua mundësojë qytetarëve të palës tjetër blerjen e polisave të sigurimit kufitar/kufitar administrativ. Nën përkujdesjen e BE, palët do të vazhdojnë të punojnë për një marrëveshje komerciale për sigurimin reciprok të automjeteve ashtu që të gjitha automjetet në të dy anët e kufirit/kufirit administrativ të jenë të siguruara sa më shpejt që është e mundur.
5. Secila palë do të marrë të gjitha masat që t'ua mundësojë qytetarëve të palës tjetër të udhëtojnë lirshëm brenda dhe përmes territorit të njëra-tjetrës me patentshoferin e lëshuar nga autoritetet e veta.
6. Si masë kalimtare, autoritetet në Kosovë do të vazhdojnë vlefshmërinë e targave KS të automjeteve për një periudhë fillestare prej pesë vitesh në përfundim të së cilës çështja do të rishikohet nga të dyja palët (me lehtësimin e BE nëse kërkohet);
7. Të gjithë pronarët e automjeteve me vendbanim në Kosovë do të përdorin targat RKS ose KS (sipas pikës 6 më lartë). Ato do të lëshohen nga autoritetet përkatëse në Kosovë dhe do të shpërndahen me ndihmën e EULEX-it kudo që kërkohet. Secila palë do të bëjë përpjekje maksimale për implementuar si më lartë;
8. Si masë e përkohshme, autoritetet në Beograd do t'ua mundësojnë automjeteve nga Kosova që bartin targat KS të qarkullojnë lirshëm në dhe përmes territorit të saj;
9. Si masë kalimtare, për cilindo pronar automjeteve që dëshiron, do të vihen në dispozicion targa të përkohshme, në pikëkalimet kufitare/kufitare administrative.
10. Përkitazi me riatdhësimin dhe duke marrë parasysh obligimet e Prishtinës në këtë fushë, pikat e marrëveshjeve më lartë nuk do të krijojnë obligime për palën e Beogradit për të pranuar kërkesat për ripranim për personat me dokumente të Kosovës në kuadër të marrëveshjes ekzistuese për ripranim ndërmjet Serbisë dhe BE.
11. Një grup implemetues, i kryesuar nga BE, do të formohet për të siguruar që marrëveshjet e lartëcekura, së bashku me pika tjera përcjellëse, të zbatohen sa më shpejt që është e mundur nga aspekti operativ, pika 7 do të zbatohet nga 1 nëntori 2011.

<sup>1</sup> Të gjitha dokumentet hyrje-dalje do të përbajnë gjuhë neutrale

**KONKLUZAT E DAKORDUARA 2 KORRIK 2011****Pranimi i Diplomave Universitare**

1. Në përputhje me praktikat më të mira evropiane, studentët duhet të kenë qasje në programet arsimore dhe në mundësi punësimi në tërë rajonin për të shfrytëzuar si është më së miri shkathhtësitë dhe talentet e tyre.
2. Të dy palët janë pajtuar në parim që të zgjidhin çështjen e pranimi të diplomave universitare përmes një trupi ndërkombëtar të dakorduar reciprokisht ose përmes një institucioni akademik të palës së tretë.
3. Detajet do të finalizohen në takimin e radhës së Dialogut.

**KONKLUZIONET E DAKORDUARA – 21 NËNTOR 2011****Pranimi i diplomave universitare**

1. Në bazë të konkluzioneve operacionale të 2 korrikut 2011 për pranimin e diplomave universitare, palët bien dakord që të kërkojnë nga Asociacioni i Universiteteve Evropiane që të bëjnë certifikimin e diplomave universitare të lëshuara nga secili universitetet që të përdoren nga tjetri në lidhje me edukimin e mëtejshëm dhe/ose punësimet publike;
2. Gjatë verifikimit të diplomave universitare të lëshuara nga institucionet e autorizuara në përputhje me praktikën më të mirë Evropiane, certifikimi do të bëhet nga një Komitet i ekspertëve akademi evropianë, themeluar nga Asociacioni i Universiteteve Evropiane.
3. Shtojcave të Diploma dhe transkripti i të dhënave që u prezantuan gjatë Dialogut, dhe konkluzionet do t'i bashkëngjiten diplomës universitare. Ajo do të jetë për autoritetet e secilës palë për të vendosur se cili nga dokumentet janë të vlefshme për këtë proces, me kusht që efekti është pranimi i kualifikimit i prezantuar nga diploma;
4. BE-ja do të bëjë çdo për të siguruar zbatimin e konkluzioneve të mësipërme nga 1 Janari 2012.

**KONKLUZIONET E DAKORDUARA 2 SHTATOR 2011****Vula doganore**

- Palët do të bëjnë çdo përpjekje të mundshme për të siguruar qarkullimin e lirë të mallrave në përputhje me marrëveshjen e CEFTA-s;
- Vulat doganore me mbishkrimin 'Dogana e Kosovës', siç u është konfirmuar të gjitha palëve të CEFTA-s, do të pranohet;
- Të gjitha dokumentet dhe komunikimet përcjellëse gjithashtu do ta pasqyrojnë këtë formulim.

### Konkluzionet përfundimtare operative, grupi implementues për lirinë e lëvizjes

1. Konkluzionet operative të dialogut për lirinë e lëvizjes të datës 2 korrik 2011 janë zbatuar në tërësi më 29 nëntor 2011;
2. Qytetarët e Kosovës që udhëtojnë në ose nëpër Serbi do të pajisen me dokument hyrje/dalje;
3. Qytetarët e Serbisë që udhëtojnë në ose nëpër Kosovë do të pajisen me dokument hyrje/dalje;
4. Dokumenti përfundimtar hyrje/dalje i secilës palë është i bashkëngjitur me këto konkluzione;
5. Pas kërkesës për konfirmim të identitetit, LNJ tregohet bashkë me këtë dokument hyrje/dalje;
6. Dokumenti hyrje/dalje quhet dokument hyrje/dalje. Gjuha në dokument hyrje/dalje do të jetë vetëm gjuhë procedurale: "dokumenti hyrje/dalje nuk bën të humbet dhe në rast të humbjes, personi gjegjës duhet t'i drejtohet stacionit më të afërt të policisë për tu pajisur me vërtetim që ai/ajo ka humbur dokumentin hyrje/dalje etj";
7. Dokumenti hyrje/dalje nuk do të përmbaj fotografi;
8. Të miturit që udhëtojnë me certifikatë lindjeje do të pajisen me dokument të veçantë hyrje/dalje dhe duhet të sjellin një fotografi me vete për të siguruar sistemin nga trafikimi i fëmijëve;
9. Në fillim do të jenë të hapura dy vendkalime, një mes Serbisë dhe Hungarisë (Horgosh) dhe një mes Serbisë dhe Kroacisë (Batrovci) për hyrje/dalje nga Serbia. Gradualisht, më vonë do të hapen të gjitha vendkalimet e tjera.
10. Në fillim do të hapen portat 1, 3 dhe 5. Gradualisht, më vonë do të hapen të gjitha vendkalimet e tjera.
11. Duke marrë parasysh konkluzionet për MIK, palët janë pajtuar që të shikojnë periudhën tranzicionale për zbatimin e pikës 7 për tabelat e regjistrimit në konkluzionet operative për lirinë e lëvizjes në dritën e situatës në terren;
12. Automjetet me tabela regjistrimi KS do të mund të udhëtojnë në/nëpër Serbi;
13. Secila palë do të vendosë skemë të sigurimit në kufi/në vijë administrative. Çmimi i sigurimit do të jetë në pajtim me çmimorën e sigurimit të aplikueshëm në kufi/në vijë, i cili aktualisht si kohë më të shkurtë parasheh periudhën njëmuajshe në palën e Beogradit. Pala e Beogradit do të bëjë çdo përpjekje për të vendosur polica më të lira sigurimi për periudha më të shkurta brenda javësh;
14. Njëkohësisht, palët, nën kujdesin e BE/Këshillit të Byrove, do të vazhdojnë të punojnë në gjetjen e aranzhimeve komerciale për mbulimin e ndërsjellë të sigurimit të automjeteve saqë të gjitha automjetet të jenë të mbuluara në dy anët e kufirit/të vijës administrative sa më shpejtë të jetë e mundur;
15. Tabelat e regjistrimit të automjeteve me RKS do të zëvendësohen me tabela të regjistrimit të përkohshëm të automjeteve në palën e Serbisë. Sa më shpejtë të jetë e mundur operacionalisht, do të zbatohet një taksë e zbritur për tabela të regjistrimit të përkohshëm të automjeteve. Pala e Kosovës do të zbatoj të njëjtën taksë;
16. Pala e Kosovës rezervon të drejtën që, pas konsultimeve me BE-në, gjithashtu të zbatojë regjimin e tabelave të regjistrimit të përkohshëm të automjeteve;
17. Në fillim, do të përdoren tabela të regjistrimit të përkohshëm të automjeteve ashtu siç janë;
18. Beograd dhe Prishtina janë zotuar të punojnë për aplikimin e tabelave "neutrale" të regjistrimit të përkohshëm të automjeteve sa më shpejtë që të jetë operacionalisht e realizueshme.

## KONKLuzionet e DAKORDUARA – 2 DHJETOR 2011

### Konkluzionet e dakorduara të IBM<sup>1</sup>-it

1. Në përputhje me Traktatin e Lisbonës dhe legjislacionin relevant të BE-së<sup>2</sup> dhe duke pasur parasysh se të dy palët janë pjesë e agjendës së BE-së për Ballkanin Perëndimor, atyre do t'ju kërkohet që gradualisht të harmonizojnë legjislacionin e tyre me atë të BE-së dhe në veçanti ta zbatojnë konceptin e IBM-it;
2. Në interes të procesimit më të shpejtë dhe më efektiv, palët, nën drejtimin e përgjithshëm të BE-së, do ta zbatojnë konceptin e IBM-it;
3. Palët kanë për qëllim që të instalojnë gradualisht objekte të përbashkëta dhe të sigurta në të gjitha vendkalimet e tyre të përbashkëta të IBM-it. Ky bashkëpunim do t'i ndjek praktikatat më të mira evropiane të cilat janë duke u zhvilluar më tutje në mënyrë progresive nga Komisioni Evropian. Kësaj pune do t'i jepet prioritet i lartë; projektet do të identifikohet bashkërisht dhe do të zbatohen sa më parë që praktikisht të jetë e mundur.
4. Objektet e përbashkëta, të integruara, të vetme dhe të sigurta do të vendosen përbrenda një "zone të përbashkët të vendkalimeve të IBM-it," të shënuar bashkërisht, ku zyrtarët e secilës palë kryejnë kontrollet përkatëse. Përfshirësisht dhe kufizuar vetëm në zonat e përbashkëta të vendkalimeve të IBM-it, palët nuk do të shfaqin simbolet e juridiksioneve të tyre përkatëse.
5. Aranzhimet do të përfshijnë një prani të balancuar, në përputhje me nevojat, nga të dy palët të shërbimeve përkatëse siç janë Doganat, Policia, etj. dhe do të përfshijnë çështje siç janë lokacioni, vendkalimet, natyra e objekteve përcjellëse, orari i punës etj. Në përputhje dhe gjatë kohëzgjatjes së mandatit të tij<sup>3</sup>, në vendkalimet Jarinjë/Rudnicë dhe Tabavije/Bërnjak, kjo prezencë do të përfshijë zyrtarë të EULEX-it. EULEX-i do të jetë i pranishëm poashtu në vendkalimet Dheu i Bardhë/Konçul, Merdare/Merdarë, Mutivodë/Mutivode dhe Depce/Muçibabë;
6. Në thelb të marrëveshjes do të jenë përgjegjësitë dhe detyrimet e qarta ligjore në fuqi sipas juridiksionit të secilës palë.
7. Një grup trepalësh implementues, kryesuar nga BE, do të formohet për zbatimin e marrëveshjeve të lartpërmendura, sa më parë që praktikisht është e mundur. Për këtë qëllim një Protokoll Teknik do të hartohet dhe nënshkruhet, nëse është e nevojshme ndarazi me BE-në, i cili do t'i marrë parasysh pikëpamjet e ndryshme të palëve lidhur me çështjen e statusit. Implikimet e këtyre konkluzioneve do të merren parasysh në zbatimin e lirisë së lëvizjes.
8. Kjo marrëveshje nuk përfshinë asnjë çështje të përgjithshme ose të veçantë që ka të bëjë me çështjet e të hyrave apo ato fiskale;

<sup>1</sup> Njëra palë e njëh vijën si kufi; pala tjetër e njëh vijën si kufi administrativ.

<sup>2</sup> Siç është përcaktuar veçanërisht me Kodin e Shengenit për Kufijtë, Rregulloren e Frontex-it, Rregulloren e Trafikut të Kufijve Lokal, Rregulloren VIS dhe Kodin e BE-së për Vizat;

<sup>3</sup> Siç është përcaktuar me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124 CEFSP, kreu 3, pjesa a.

23 shkurt 2012

**Protokolli Teknik për zbatimin e Konkluzave të Dakorduara të Dialogut IBM-it<sup>1</sup> të 2 dhjetorit 2011**

**A. Dispozitat e përgjithshme:**

1. Në përputhje me konkluzat e dakorduara të IBM-it, me Traktatin e Lisbonës dhe legjislacionin relevant të BE-së<sup>2</sup> dhe duke pasur parasysh se të dyja Palët janë pjesë e agjendës së BE-së për Ballkanin Perëndimor, atyre do t'ju kërkohet që gradualisht të harmonizojnë legjislacionin e tyre me atë të BE-së dhe në veçanti ta zbatojnë konceptin e IBM-it, ashtu siç paraparë në Konkluzionet e Këshillit të Bashkimit Evropian të 4-5 dhjetorit 2006;
2. Duke vepruar në mirëbesim, Palët do t'i vendosin dhe do të fillojnë funksionalizimin e pikëkalimeve të përbashkëta të IBM-it (në tekstin e mëtejshëm "PK") Jarinjë/Rudnica; Bërnjak/Tabalije; Dheu i Bardhë/Konçul; Merdarë/Merdare; Mutivodë/Mutivoda and Muçibabë/Depce;
3. "PK-të" do të vendosen në zonën e përbashkët të IBM-it (në tekstin e mëtejshëm "ZPK") ku një prani e balancuar e të gjitha autoriteteve kompetente, në përputhje me nevojat, siç janë Dogana, Policia, Fitosanitaria dhe Veterina dhe shërbimet e tjera përcjellëse dhe ndihmëse të secilës palë do të kryejnë kontrollat ndarazi brenda pjesës së vetë të zonës së përbashkët të IBM-it, në përputhje me përgjegjësitë dhe obligimet ligjore përkatëse nën jurisdikcionin e vetë përkatës, duke respektuar në plotëni të drejtat e njeriut të garantuara me standarde evropiane dhe ndërkombëtare;
4. Vendosja e "PK-ve" brenda "ZPK" do të thjeshtësojë kryerjen e aktiviteteve që lidhen me kontrollin e personave, mallrave dhe automjeteve në "PK", në interes të lehtësimit të kalimit të personave, automjeteve dhe mallrave si dhe të parandalimit, detektimit dhe hetimit të çfarë aktiviteti kriminal;
5. Palët do të fillojnë së vendosuri dhe funksionalizuar "PK-të/ZPK" Jarinjë/Rudnice, Dheu i Bardhë/Konçul, Bërnjak/Tabalije dhe Merdarë /Merdare. Vendosja dhe funksionalizimi i "PK-ve/ZPK" Muçibabë/Depce dhe Mutivodë/Mutivode do të fillojë në një fazë të mëvonshme;
6. Në përputhje dhe gjatë kohëzgjatjes së mandatit të tij<sup>3</sup>, në vendkalimet Jarinjë/Rudnicë dhe Tabavije/Bërnjak, kjo prezencë do të përfshijë zyrtarë të EULEX-it. EULEX-i do të jetë i pranishëm poashtu në vendkalimet Dheu i Bardhë/Konçul, Merdare/Merdarë, Mutivodë/Mutivode dhe Depce/Muçibabë;
7. Komisioni Evropian (Drejtoria e Përgjithshme për Zgjerim), pas konsultimit me Palët dhe EULEX-in, do të hulumtohen mundësitë për financimin e zhvillimit të "PK/ZPK". Gjithashtu, do të hulumtohen mundësitë për bashkëfinancim të "PK/ZPK" ndërmjet Palëve;

<sup>1</sup> Njëra palë e njëj vijën si kufi shtetëror; pala tjetër e njëj vijën si kufi administrativ.

<sup>2</sup> Siç është definuar në Kodin Kufitar të Shengenit, Rregulloren e Frontextit, Rregulloren për Trafikun e Kufinjve Lokalë, Rregulloren VIS dhe Kodin e Komunitetit për Vizat.

<sup>3</sup> Siç është paraparë në Council Joint Action 2008/124 CEFSP, Neni 3, Pika a.

8. Në prirje të procedurave financiare të përmendura në pikën 8, Palët do të hulumtojnë mundësitë e vendosjes së shpejtë të objekteve të përkohshme për praninë e shërbimeve të parapara në pikën 3. BE do të bëjë përpjekjet më të mira për t'i angazhuar Palët për zbatimin e kësaj sa më parë që është praktikisht e mundur pas hyrjes në fuqi të këtij Protokolli;
9. Liria e lëvizjes do të vazhdojë sipas marrëveshjes në konkluzat e Dialogut.

#### **B. Grupi implementues**

10. Një grup i ri trepalësh (tash e tutje në tekst i referuar si IG) siç është paraparë të themelohet nga konkluzionet e Dialogut dhe i kryesuar nga BE, do të formohet pas përfundimit të këtij Protokolli Teknik dhe do të jetë përgjegjës për zbatimin e këtij Protokolli Teknik, do të ketë mundësi të propozojë masa ose zgjidhje lidhur me çështjet që lidhen me zbatimin e këtij Protokolli Teknik dhe të propozojë masa për zgjidhjen e kontesteve dhe/ose konflikteve. GI do t'i miratojë procedurat e veta të punës;
11. GI do të takohet dy herë në vit në nivel të lartë. Përveç kësaj, GI mund të thirret në këtë nivel me kërkesë të cilësdo Palë.
12. Përbërja/nivelet e GI janë të parapara në pjesën E të këtij Protokolli Teknik;

#### **C. 'PK/ZPK'**

13. Përmes këtij Protokolli Teknik, Palët, brenda një "ZPK" të shënuar bashkërisht, do të vendosin objekte dhe infrastrukturë adekuate të "PK" për një prani të balancuar, në përputhje me nevojat, nga të dy palët të të gjitha organeve kompetente të secilës Palë për kryerjen e kontrolleve në përputhje me përgjegjësitë dhe detyrimet e veta përkatëse ligjore në fuqi;
14. Objektet e përbashkëta, të integruara, të vetme dhe të sigurta do të vendosen përbrenda një "zone të përbashkët të vendkalimeve të IBM-it," të shënuar bashkërisht, ku zyrtarët e secilës palë kryejnë kontrollet përkatëse. Fasilituar nga BE, Grupi teknik trepalësh do të dakordojë hollësitë lidhur me vendosjen e zonave të përbashkëta të IBM-it duke i marrë parasysh kushtet gjeografike dhe teknike në terren. Secila palë do të vendosë për lokacionin e zonave të përbashkëta të IBM-it në pjesën e vetë të territorit;
15. "ZPK-të" do të përfshijnë segmentet rrugore, të objekteve, të objekteve ndihmëse, objekteve përcjellëse siç janë toaletet, rrethojat dhe ndriçimi ose çfarëdo hapësire ose objekt i nevojshëm për zbatimin e kontrolleve/procedurave përkatëse nga organet kompetente përkatëse;
16. Dizajni i çdo "PK/ZPK" duhet t'i përmbahet skemës së "PK/ZPK" të diskutuar nga Palët, e cila do t'i përshtatet kushteve/nevojave/ komunikacionit/relievit të çdo "PK/ZPK";
17. Secila Palë do të mbulojë shpenzimet operative/të mirëmbajtjes në pjesën e vetë të "PK/ZPK";
18. "PK/ZPK" do të funksionojë 24/7. Palët do ta njoftojnë njëra-tjetrën për procedurat e tyre për procesimin e personave, automjeteve dhe mallrave dhe për çdo ndryshim të tyre;



19. Policia do të operojë në të gjitha "PK/ZPK" zakonisht me orar të punës me ndërrime 12 orëshe të cilat do të harmonizohen ndërmjet Palëve për të siguruar një qarkullim të pandërprerë të njerëzve, automjeteve dhe mallrave. Hollësitë tjera do të diskutohen dhe dakordohen nga GI. Dogana do të operojë me orar të njëjtë të punës në të gjitha "PK/ZPK" me përjashtim të Mutivodës/Mutivode ku Policia do të jetë autoriteti i vetëm i pranishëm. Shërbimet fitosanitare dhe veterinarë do të operojnë vetëm brenda Terminaleve Doganore zakonisht me ndërrime 12 orëshe të cilat do të harmonizohen ndërmjet Palëve për të siguruar një qarkullim të pandërprerë të njerëzve, automjeteve dhe mallrave nëpër "PK/ZPK". Procesimi/qarkullimi i kafshëve të gjalla dhe bimëve do të bëhet përmes "PK/ZPK" Merdarë/Merdare dhe Jarinjë/Rudnica.
20. Gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare në zonën e përbashkët të menaxhimit të integruar kufitar, zyrtarët nga të dyja Palët do të gëzojnë imunitetet dhe privilegjet përkatëse dhe t'iu përgjigjen organeve të veta kompetente të origjinës.
21. Zyrtarët e secilës Palë, gjatë hyrjes-daljes dhe gjatë ushtrimit të detyrave të tyre zyrtare duhet t'i bartin uniformat dhe emblemat e tyre zyrtare;
22. Zyrtarët e secilës Palë do të bartin një kartën zyrtare të identifikimit dhe një autorizim zyrtar të cilat i japin të drejtë zyrtarit që të hyjë dhe punojë në pjesën e vetë të "ZPK". Karta zyrtare e identifikimit duhet të lëshohet nga organi kompetent i secilës palë. Secila Palë e njofton Palën tjetër se cilat karta identifikimi janë të vlefshme për hyrje-dalje në "ZPK";
23. Në pjesën e vetë të zonës së përbashkët të menaxhimit të integruar kufitar, përdorimi i forcës dhe masat e tjera të zbatimit të ligjit nga e Palëve rregullohen me legjislacionin e përkatës të secilës Palë;
24. Përjashtimisht dhe kufizuar vetëm në zonat e përbashkëta të zonës së përbashkët të menaxhimit të integruar kufitar Palët nuk do të shfaqin simbolet e juridiksioneve të tyre përkatëse<sup>3</sup>;
25. Informacionet funksionale në "ZPK" do të postohen në gjuhët zyrtare. Përveç kësaj, tekstet do të postohen edhe në anglisht;

#### **D. Funksionimi i "PK/ZPK"**

26. Brenda "ZPK", procesimi i personave, automjeteve dhe mallrave nga zyrtarët e territorit të daljes do të kalojnë të procesohen nga zyrtarët e territorit të hyrjes. Pas largimit nga territorit i daljes, personat, automjetet dhe mallrat nuk mund të procesohen më nga zyrtarët e daljes përveç nëse u është refuzuar hyrja nga zyrtarët e territorit të hyrjes;
27. Personat dhe mallrat të cilëve u është refuzuar hyrja në territorin e njërit Palë duhet të kthehen në territorin e Palës tjetër;
28. Lidhur me azilin dhe migracionin do të zbatohen ligjet përkatëse të secilës Palë;
29. Kontrolli i lehtësuar mund të zbatohet në rrethana të jashtëzakonshme dhe të paparishikueshme të shkaktuara nga shkalla e shtuar e qarkullimit. Në këto raste, autoritetet kompetente të secilës Palë do të marrë masa për lehtësimin e trafikut të

<sup>3</sup> Kjo është përkufizuar mëtej në letrën e Lehtësuesit dërguar secilës palë me 6 dhjetor 2011.

ngjeshur. Masat e tilla të lehtësuara do të vendosen vetëm në baza të përkohshme. GI do të hartojë dhe dakordojë hollësi të tjera varësisht sipas rrethanave dhe nevojave;

30. Palët do të hartojnë dhe vendosin plane rezervë lidhur me ngjarje të mundshme të paparashikuara dhe/ose të papritura. Në rastet e tilla, Palët, në bazë të kërkesës, do t'i ofrojnë njëra-tjetrës ndihmë reciproke. Hollësitë do të hartohen dhe dakordohen nga GI;

#### **E. Shkëmbimi, përpunimi dhe përdorimi i informatave**

31. Pa paragjykuar çfarëdo obligimi në të cilat kanë hyrë Palët me BE-në dhe/ose organizatat ndërkombëtare, Palët do të vendosin mekanizma me qëllim të shkëmbimit të informatave dhe të dhënave tjera të cilat janë ose mund të jetë relevante për parandalimin, detektimin dhe hetimin e aktiviteteve kriminale si dhe për mbrojtjen e jetërave dhe shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe bimëve, ambientit dhe sigurisë së ushqimit në pjesën e tyre të përgjegjësisë, duke përfshirë shkëmbimin e të dhënave statistikore të qarkullimit të njerëzve dhe të mallrave me qëllim të zbulimit të aktiviteteve të paligjshme;
32. Asnjëra Palë nuk do t'i përdorë informata dhe të dhënat e tjera të ofruara nga pala tjetër përpos për qëllimet e përmendura në pikën 31 e as nuk do t'ua vëjë ato informata në dispozicion një Pale tjetër, përveç organeve përkatëse të BE-së. I tërë përpunimi i të dhënave do të bëhet në përputhje të plotë me standardet e BE-së për mbrojtjen dhe përpunimin e të dhënave;
33. GI, në format adekuat për plotësuar kushtet e përmendura në pjesën E do të jetë përgjegjëse për të siguruar shkëmbimin, përpunimin dhe përdorimin e informatave;
34. Për këtë qëllim do të mbahen takime të rregullta në të gjitha nivelet (lokale, regjionale, qendrore). Intervallet e këtyre takimeve do të rregullohen dhe dakordohen nga GI;
35. GI do të hartojë/miratojë dispozita të hollësishme për shkëmbimin, përpunimin dhe përdorimin e informatave dhe të dhënave tjera siç parashihet në pikën 32, në përputhje të plotë me standardet e BE-së;
36. BE do të bëjë përpjekjet më të mira për të lehtësuar shkëmbimin e informatave nga Palët përmes nismave/projekteve/sistemeve të vendosura nga BE (psh. Sistemi i Shkëmbimit Elektronik i të Dhënave (S.E.E.D.)etj.);

#### **F. Përgjegjësitë/Obligimet**

37. Për çdo kundërvajtje ose shkelje penale si dhe për çdo obligim ose dëm në lidhje me kryerjen e detyrës zyrtare në "ZPK", Pala e cila e ka caktuar zyrtarin i cili ka kryer veprime të tilla do të jetë përgjegjëse dhe legjislativi i Palës përkatëse / autoritetet përkatëse të zbatimit të ligjit janë përgjegjëse;
38. Pala e njofton menjëherë palën tjetër në rast të kundërvajtjes ose shkeljes penale nga ana e ndonjë zyrtari të saj;
39. Lehtësuar nga BE, Palët do të synojnë të vendosin ndihmë reciproke ligjore;

#### **G. Dispozitat përfundimtare**

40. Lehtësuar nga BE, zbatimi i këtij Protokollit Teknik do të fillojë menjëherë pas nënshkrimit të tij. Për këtë qëllim, Grupi trepalësh Teknik do të mbledhet menjëherë pas nënshkrimit të Protokollit Teknik;
41. Ndryshimet në këtë protokoll do të diskutohen dhe dakordohen nga ana e GI;
42. Pas konsultimit me BE-në, secila palë është e lirë të njoftojë për shkëputjen e këtij Protokollit Teknik gjë që do zbatohet përmes njoftimit të të gjitha Palëve të këtij Protokollit Teknik. Shkëputja do të hyjë në fuqi dymbëdhjetë muaj pas njoftimit;
43. Pas shkëputjes së këtij Protokollit Teknik, mjetet e ofruara nga secila Palë do të mbesin në pronësi të asaj Pale. Mjetet e ofruara përmes financimit të BE-së do të trajtohen në përputhje me dispozitat në Termat e Referencës dhe/ose kontratat.

## KONKLuzionet e DAKORDUARA – 24 SHKURT 2012

### Aranzhimet lidhur me Përfaqësimin dhe Bashkëpunimin Rajonal

1. Të dy palët konfirmojnë përkushtimin e tyre për përfaqësim dhe bashkëpunim rajonal efektiv dhe gjithëpërfshirës.
2. Për përmbushje të kësaj 'Kosova\*' është denominimi i vetëm që do të përdoret në kornizën e bashkëpunimit rajonal.
3. Fusnota që do të aplikohet në asteriskun e cekur në paragrafin 2 është *"Ky shënim është pa paragjykim të pozicioneve për status dhe është në linjë me RKSKB 1244 dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës."*
4. 'Kosova\*' merr pjesë në interes të saj dhe flet për veten e saj në të gjitha takimet rajonale.
5. Kur iniciohen dhe/ose nënshkruhen marrëveshje të reja, përfaqësuesi i Kosovës\*' do të nënshkruan sipas përcaktimit në paragrafët 2 dhe 3.
6. Sa i përket modifikimeve të marrëveshjeve ekzistuese e të nënshkruara nga UNMIK-u, asgjë në këto konkluzione nuk do të interpretohet me paragjykim për të drejtat legale të UNMIK-ut. Përfaqësuesi i Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) do të ftohet në takimet e organizuara në kuadër të marrëveshjeve ku është nënshkruar. UNMIK do të vendos nëse dëshiron të merr pjesë në ndonjërin nga këto takime.
7. Nikoqiri i takimeve do të inkurajohet që të shmang shpërfaqjen e simboleve shtetërore përveç të tij dhe të BE-së, duke marrë parasysh statutet e organizatave relevante.
8. BE-ja si ndërmjetësuese do t'i informojë organizatat relevante rajonale dhe etnitetet për aranzhimet për denominimin, përfaqësimin dhe nënshkrimin. Ato duhet të reflektohen në takimet e ndryshme rajonale. BE-ja do ta monitoroj zbatimin e këtyre aranzhimeve.
9. Të dy palët dhe BE-ja do t'i nxisin partnerët që të mbështesin këto aranzhime dhe të ndihmojnë në zbatimin e tyre.
10. Organizatat rajonale për të cilat bëhet fjalë në këto konkluzione janë ato ekzistueset dhe të tjerat që do të themelohen, ndërqeveritare ose aranzhime që kanë për qëllim që të promovojnë bashkëpunimin ose integrimin në rajonin të Ballkanit. "Takimet rajonale" përfshirë takimet e këtyre organizatave dhe poashtu takimet ad-hoc ose takimet jo-formale me qëllime të ngjashme. Kjo gjithashtu përfshinë takimet me institucionet e BE-së në kontekst të agjendës Evropiane.
11. Këto aranzhime janë aprovuar në baza të përkohshme.



Republika e Kosovës  
 Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Punëve të Jashtme / Ministarstvo Inostranih Poslova / Ministry of Foreign Affairs*

DATA	22. 04. 2012
REFERENCË:	
PËR/ZA/TO:	
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	

Bazuar në nevojat e definimit të qartë të kushteve për pjesëmarrje në takime të karakterit rajonal për delegacionet e të gjitha niveleve të zyrtarëve të Republikës së Kosovës, porpozojmë aprovimin e Udhëzimit Administrativ për Pjesëmarrje në Takime Rajonale, duke u bazuar në interpretim të saktë dhe konciz të dispozitave të marrëveshjes së nënshkruar në Bruksel në shkurt 2012.

### Propozim Udhëzim Administrativ për pjesëmarrjen në takimet rajonale:

Në të gjitha takimet rajonale delegacioni i Republikës së Kosovës duhet të respektojë parimin e reciprocitetit ndaj delegacionit të Serbisë.

1. Ky udhëzim vlen për të gjitha "organizatat e tashme ose të ardhshme ndër-qeveritare ose marrëveshje që kanë qëllim promovimin e bashkëpunimit apo integritet në organizata e nisma rajonale" [Pika 10 e Marrëveshjes]. Lista e organizatave është e koordinuar në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës/Grupit Punues ndërqeveritar të republikës së Kosovës dhe BE-së/ndërmjetësuesit të BE-së, Robert Cooper.

2. Duke u nisur nga pika 2 e Aranzhimeve që kanë të bëjnë me përfaqësimin rajonal dhe bashkëpunimin (shih dokumentin shtojcë, versioni në gjuhën angleze), denominimi "Kosova\*" (në version anglisht "Kosovo\*"), është "i vetmi denominim që do të përdoret në korniza të bashkëpunimit rajonal" [Pika 2 e Marrëveshjes]

3. Denominimi i Kosova\* është edhe teksti i vetëm që do të paraqitet te denominimi i vendit, qoftë në tabela të tavolinës, dokumente të botuara, apo material tjetër të ndërlidhur me takimet e nivelit rajonal.

4. Fusnota shpjeguese me tekstin origjinal "This designation is without prejudice to positions on status, and is in line with UNSC1244 and the ICJ Opinion on the Kosovo declaration of independence", përdoret në fund të faqes së parë e dokumenteve të printuara. Fusnota NUK ËSHITË pjesë integruese e denominimit/emrit dhe nuk mund të figuron në tabela emrash në tavolina ku shënohen vetëm emrat e pjesëmarrësve, përkatësisht emrat e shteteve.

5. Emri i Kosovës me asterisk do të jetë i barabartë në madhësi, stil, font dhe ngjyrë me të gjitha emrat tjerë të shteteve participuese në të gjitha tabelat tjera në tavolinë.

6. Sipas marrëveshjes së 24 shkurtit në Bruksel ndërmjet Kosovës dhe Serbisë [Pika 7], nikoqiri i takimeve do të "inkurajohet të shmanget në përdorimin e simboleve

shtetërore po si flamujve të nikoqirit dhe BE'së", dhe rrjedhimisht nëse organizatori përdorë simbolet shtetërore të shteteve tjera pos të nikoqirit dhe të BE'së, atëherë ai është i obliguar të vendosë edhe simbolet e Republikës së Kosovës. Në rast se një e tillë nuk ndodh, duhet të kërkohet nga organizatori vendosjen e simboleve të shtetit të Kosovës në linjë me qëllimin e përfaqësimit të barabartë të Kosovës dhe sigurimit të "zërit të mëvetësishëm të Kosovës".

7. Nëse pala serbe lexon tekste nga kushtetuta e tyre apo bënë deklarata provokuese atëherë pala e Kosovës gjatë paraqitjes së saj duhet të lexojë tekste nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Teksti që duhet lexuar është:

"Republika e Kosovës është shtet i pavarur, sovran dhe demokratik i qytetarëve të saj. Shteti i Kosovës është njohur nga 88 vende, si nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, 22 shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, shumica e shteteve të rajonit dhe më gjerë si dhe është anëtare e agjencioneve të specializuara të OKB'së si Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar. Gjykata Ndërkombëtare për Drejtësi ka konfirmuar legjitimitetin e Deklaratës për pavarësinë e Kosovës, ndërsa Asambleja Gjenerale e OKB'së ka konfirmuar opinionin e GJND'së"

8. Për çdo anashkalim të marrëveshjes në këto nisma, delegacioni i Kosovës duhet të paraqes vërejtjet e tij tek përfaqësuesit e BE-së, e cila si ndërmjetëse do t'i informojë organizatat relevante rajonale dhe entitetet për aranzhimet për denominimin, përfaqësimit dhe nënshkrimit. Kjo është me rëndësi për faktin se BE-ja është garantuese e zbatimit të këtyre aranzhimeve.

9. Informohen të gjitha ministrinë Qeverisë së Kosovës se pikat kontaktuese lidhur me çështje të implementimit të përfaqësimit në nismat rajonale do të jetë Grupi Ndërqeveritar Punues dhe zyrtarët e deleguar Drejtor i në MPJ Sylë Ukshini dhe këshilltari i jashtëm Ambasador Agon Demjaha. Zyrtarët Lirim Grejcevc i nga ZKM dhe Elona Cecelia nga Zyrja e Zëvendës Kryeministres dhe Udhëheqëses së dialogut teknik përmbyllinqarkun e zyrtarëve

10. Instruksionet në këtë Udhëzim nuk vlejnë për organizatat që tejkalojnë agjendën rajonale, si OKB dhe trupat derivues të OKB'së si dhe ato të NATO's apo organizatave tjera ku pjesëmarrja e Kosovës kushtëzohet nga vetoja e shteteve jonjohëse.

**Kushtet nën të cilat delegacionet e Kosovës udhëzohen të lëshojnë takimet multilaterale rajonale:**

- a. Përfaqësimi i Kosovës nuk është i barabartë dhe reciprok.
- b. Tabela e emrit pos emrit dhe yllit shënjes, përbënë edhe tërë tekstin e fusnotës.
- c. Emri i Kosovës në tabelë nuk është i njëjtë si emrat e shteteve tjera në madhësi dhe format.
- d. Fusnota përdoret e shkurtuar pa referencë në Mendimin e GJND mbi Deklaratën e Pavarësisë.
- e. Nëse ka flamuj dhe simbole tjera shtetërore të shteteve tjera pos nikoqirit dhe BE'së, e nuk është prezent flamuri dhe simbolet tjera shtetërore të Kosovës.
- f. Nëse insistohet nga organizatorët të flet UNMIK apo të përfaqësoj UNMIK në çfarëdo formati institucionet e Kosovës. UNMIK mund të jetë prezent si i ftuar i veçantë por jo si pjesë e delegacionit të Kosovës, jo si përfaqësues i Kosovës, apo i autorizuar të flas në emër të saj.



### Aranzhimet lidhur me Energjinë

1. Të dyja palët e konfirmojnë zotimin e tyre për të përbushur të gjitha detyrimet sipas Traktatit të Komunitetit për Energjinë dhe për zbatimin e *aquis* së BE-së për energjinë. Këto aranzhime janë në përputhje të plotë me të dyja.

2. KOSTT-i dhe EMS-i do të nënshkruajnë një marrëveshje bilaterale të operimit brenda tre muajve, duke vendosur dhe rregulluar marrëdhëniet e ndërsjella si dy Operatorë të Sistemit të Transmisionit. Si rrjedhojë, Marrëveshja e mëhershme e përkohshme mbi shkëmbimin e energjisë dhe Marrëveshja e përkohshme teknike do të shfuqizohen.

KOSTT do të njihet si Operator i Sistemit të Transmisionit për territorin e Kosovës me qëllim të pjesëmarrjes në të gjitha mekanizmat relevantë (ITC, Menaxhimin e Kongjestionit, et).

EMS do të mbështesë KOSTT-in që të bëhet anëtare e ENTSO-E-së.

3. Autoritetet rregullatore për energji të të dyja palëve do të hapin kanale të drejtpërdrejta të komunikimit për të diskutuar mbi çështjet me interes të ndërsjellë.

Autoritetet rregullatore të të dyja palëve do të, në aplikim, pa vonesa, dhe në përputhje me ato që kërkohen nga korniza ekzistuese për licencim në juridiksionin e tyre, të lëshojnë licencë për mbulim tregtie (import, eksport, transit) dhe furnizim për KEK-un, KEDS-in dhe EPS-in, respektivisht.

4. Të dyja palët do të përshpejtojnë procesin e hapjes së tregut deri më 1 korrik 2014, sipas afateve të përcaktuara nga Traktati i Komunitetit të Energjisë, duke lejuar themelimin e një kompanie të re që do të furnizojë konsumatorët. Të dyja palët po ashtu pajtohen që një kompani e tillë do të themelohet sipas kornizës ligjore dhe rregullatore të Kosovës.

5. Kjo kompani e re do të furnizojë me energji dhe mund të ofroj shërbime të distribuimit (siç janë faturimi, inkasimi, mirëmbajtja dhe lidhja fizike konsumatorët të rinj) për konsumatorët në katër komunat me shumicë serbe të pjesës veriore dhe mund ta ketë mundësinë që të blejë dhe shes energji në tregun e hapur. Kjo kompani e re, në mënyrë që të operojë sipas pikës 4 do të nënshkruajë marrëveshje me KOSTT-in në mënyrë që të merr pjesë në tregun e energjisë së Kosovës dhe për t'u bërë palë përgjegjëse për balancë.

Menjëherë pasi të krijohet kjo kompani e re, ajo do të hyjë në bisedime me KEDS-in dhe KOSTT-in për të gjitha çështjet tjera me interes të ndërsjellë, duke përfshirë sigurimin e qasjes si palë e tretë.

Punëtorët e JP Elektrokosmet do të inkuadrohen në këtë kompani të re ose do t'u ofrohet punësim në KEDS.

KOSTT-i do të rilidh linjën 110 kv në Vallaq. Operatorët aktual në nënstacionin e Vallaqit do të respektojnë urdhrat e qendrës dispeçere të Kosovës.

6. Të dyja palët pajtohen që të provojnë të gjejnë zgjidhje të përbashkët në lidhje me kërkesat e KOSTT-it dhe të EMS-it. KOSTT-i konsideron se këto kërkesa janë për tranzitin e papaguar dhe alokimet e të hyrave të interkoneksionit dhe kërkesat e EMS-it për rregullim sekondar. EMS konsideron se këto kërkesa janë për shërbimet për rregullime sekondare dhe terciare. Nëse do të jetë e pamundur që të arrihet një marrëveshje e përbashkët brenda 6 muajve, të dyja palët do të pajtohen që kërkesat e tyre ti nënshtrohen një arbitrazhi ndërkombëtarë.
7. Do të formohet një grup implementues në mënyrë që të hartohet një Plan të plotë Veprimi për zbatimin e marrëveshjes së ardhshme. Procesi i plotë i implementimit do të fillojë pas pranimit me shkrim të planit të veprimit.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*  
*Ministria e punëve të brendshme – Ministarstvo unutrašnjih poslova*  
*Ministry of Internal Affairs*

Më 9 janar 2013

I nderuari z. Gjentillini [Gentilini],

Bashkëngjitur mund të gjeni Procedurat për ndihmë të ndërsjellë juridike, të dakorduara nga Grupi implementues për zbatimin e Prokollit teknik për MIK më 13 dhjetor 2012.

Më lejoni që të ju shprehi konsideratat e mia më të larta.

Fisnik Rexhepi  
Koordinator i Kosovës për GI MIK  
*[vula e MPB-së]*

Përktheu/Preveo:  
Bruno Nazira]

### Procedurat për ndihmë të ndërsjellë juridike

Duke ditur që përpjekjet për mbështetjen e sundimit të së drejtës avancohen me qasje bashkëpunuese dhe në pajtim me Protokollin teknik për zbatimin e Konkluzave të dakorduara të dialogut për MIK<sup>1</sup>, palët pajtohen të krijojnë procedura të cilat lehtësojnë procedimin e kërkesave për Ndihmë të ndërsjellë juridike (NNJ):

1. Palët do të krijojnë një kanal komunikimi për NNJ ndërmjet organeve të tyre përgjegjëse, në pajtim me juridiksionin relevant të secilës palë;
2. Fushëveprimi i kërkesave që do të barten do të përbëhet nga:  
2.1 Kërkesat e përgjithshme për NNJ
3. Palët pajtohen që nga EULEX-i, në përputhje dhe gjatë kohëzgjatjes së mandatit të tij, do të kërkohet të veprojë si ndërmjetës për të ndërmjetësuar komunikimin vetëm me transmetimin e kërkesave për NNJ dhe përgjigjet e palëve për to. Palët pajtohen që EULEX-i, në përputhje dhe gjatë kohëzgjatjes së mandatit të tij, në asnjë mënyrë nuk mund të thirret në përgjegjësi për dëmet ose të jetë përgjegjës për mospërfitime në zbatimin e kërkesave.
4. Teknikisht, ndërmjetësimi në komunikim ndërmjet palëve do të bëhet si vijon: organi kërkues do t'ia dorëzojë kërkesat ose përgjigjet EULEX-it, në përputhje dhe gjatë kohëzgjatjes së mandatit të tij. Pas pranimit, EULEX-i, në përputhje dhe gjatë kohëzgjatjes së mandatit të tij, do të bashkëngjijë një shkresë përcjellëse në të cilën do të specifikohen bashkëngjitjet e kërkesës ose përgjigjes, dhe do ta bartë atë me dokumentet e bashkëngjitura të pala pranuese sipas rastit.
5. Procedurat e paraqitura nuk do të ndikojnë në detyrimet e palëve lidhur me juridiksionin relevant të zbatueshëm, traktatet ose aranzhimet e tjera në fuqi.
6. Palët do të përpiqen që të zgjidhin çfarëdo mosmarrëveshje që mund të shfaqet lidhur me pranimin, zbatimin ose realizimin e këtyre procedurave. Me ndërmjetësim të EULEX-it, në përputhje dhe gjatë kohëzgjatjes së mandatit të tij, palët do të takohen së paku një herë në vit për këtë dhe me qëllim të vlerësimit dhe përmirësimit të zbatimit të këtyre procedurave. Për më tej, me kërkesë, palët mund të takohen në çfarëdo niveli kompetent të palëve, përfshirë EULEX-in, në përputhje dhe gjatë kohëzgjatjes së mandatit të tij. EULEX-i, në përputhje dhe gjatë kohëzgjatjes së mandatit të tij, do të mbajë shënime zyrtare, për të cilat do të pajtohen palët.

*[vula e MPB-së]*

<sup>1</sup> Njëra palë e njëj vijën si kufti shtetëror; pala tjetër e njëj vijën si kufti administrativ.

7. Palët do të përballojnë kostot dhe shpenzimet e veta që paraqiten lidhur me pranimin, zbatimin ose realizimin e këtyre procedurave.
8. Pas konsultimit me BE-në, secila palë është e lirë të njoftojë për shkëputjen e këtyre procedurave, gjë që do zbatohet përmes njoftimit të të gjitha palëve. Shkëputja do të hyjë në fuqi tre muaj pas njoftimit.
9. Pas pranimit të këtyre procedurave me shkrim nga secila palë, BE-ja do të njoftoj palët për hyrjen në fuqi të këtyre procedurave.

*[vula e MPB-së]*

Përkthues/Preved:  
Bruno Nestraj

## Marrëveshja e Brukselit mbi Mbledhjen e të Hyrave Doganore

17 janar 2013

Përfundimet e Kryesuesit, Grupi Punues (GP) Doganor, 10 -17 janar 2013:

Në harmoni me përfundimet relevante të mëparshme të dakorduara (në veçanti mbi MIK)<sup>1</sup>, me Marrëveshjen e CEFTA-së, Traktatin e Lisbonës dhe legjislacionin relevant të BE-së<sup>2</sup> dhe duke pasur parasysh që të dyja Palët janë pjesë e agjendës së BE-së për Ballkanin Perëndimor, Palët janë pajtuar si në vijim:

### A. Grumbullimi i detyrimeve doganore, detyrimeve të akcizës dhe TVSH-së:

1. Të gjitha mallrat, pavarësisht llojit, sasisë dhe vlerës mund të hyjnë në Kosovë<sup>3</sup> përmes PKD-ve të MIK në Jarinje/Rudnica dhe në Tabavije/Bërnjak .

2. Për mallrat e liruar në qarkullim të lirë dhe të paracaktuara për kompanitë dhe ndërmarrjet e regjistruara dhe/ose individët që jetojnë në Leposaviq, në veri të Mitrovicës, Zubin Potok dhe Zveçan, të gjitha detyrimet doganore dhe Akcizore e poashtu edhe të TVSH-së do të mblidhen në pajtim me paragrafin 3 në objektet që gjenden në Pikë Kalimet doganore në zonën e përbashkët të MIK-ut (që këtej e tutje do të quhet si "ZPKD") nëse këto mallra kanë hyrë përmes PKD-ve Jarinje/Rudnica dhe Tabavije / Bërnjak. Të gjitha mallrat tjera që kanë hyrë përmes PKD-ve Jarinje/Rudnica dhe Tabavije/Bërnjak do të drejtohen për në Terminalin e Mitrovicës jugore për t'u liruara.

3. Procedurat e lirim, përfshirë të gjitha kontrollat e nevojshme, do të realizohen në pjesën e Kosovës nga autoritetet Kosovare në pajtim me përgjegjësitë e tyre ligjore dhe detyrimet sipas këtij juridiksioni (përfshirë normat doganore, Akcizore dhe të TVSH-së), plotësisht duke i respektuar të drejtat e tyre njerëzore të garantuara nga standardet Evropiane dhe ndërkombëtare; EULEX do të jenë të pranishëm, në harmoni me dhe gjatë mandatit të tyre<sup>4</sup> dhe në pajtim me marrëveshjen për MIK.

4. Regjistrimi i kompanive dhe ndërmarrjet që referohen në paragrafin 2 do të bëhen për qëllimet e kësaj marrëveshjeje. Regjistrimi do të bazohet në dokumentacionin ekzistues dhe në pajtim me paragrafin 3.

5. Për kompanitë dhe ndërmarrjet në Leposaviq, në veri të Mitrovicës, Zubin Potok dhe Zveçan të themeluara para se kjo marrëveshje të ketë hyrë fuqi, të gjitha dokumentet regjistruese të mëparshme automatikisht do të konsiderohen të vlefshme për regjistrim.

<sup>1</sup> Njëra palë e pranon vijën si kufi, pala tjetër e pranon vijën si kufi administrativ.

<sup>2</sup> Në veçanti Rregullorja e Këshillit (KE) Nr. 2007/2000 e 18 shtatorit 2000 që paraqet masat e jashtëzakonshme tregtare për vendet dhe territoret pjesëmarrëse ose të lidhura me procesin e BE-së mbi Stabilizimin dhe Asociacionin, sipas plotësimiit.

<sup>3</sup> \* Ky përcaktim nuk është paragjykes nga pozitës së statusit dhe është në harmoni me Rezolutën 1244/99 dhe Mendimin e Gjykatës për Drejtësi Ndërkombëtare mbi Deklarimin e Pavarësisë nga Kosova.

<sup>4</sup> Siç është përcaktuar nga Akti i Përbashkët i Këshillit 2008/124 CEBSP, Neni 3, Pjesa a

Në vijim të hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, regjistrimet / ndërmarrjet për kompanitë e reja do të kryhen në pjesën Kosovare të ZPKD-së nga autoritetet Kosovare në pajtim me përgjegjësitë e tyre ligjore dhe detyrimet sipas këtij juridiksioni, duke i respektuar plotësisht të drejtat njerëzore të cilat janë të garantuara sipas standardeve Evropiane dhe ndërkombëtare; EULEX-i do të jetë i pranishëm, në harmoni me dhe gjatë mandatit të tyre.<sup>5</sup> I gjithë dokumentacioni relevant mund të përdoret për regjistrim dhe mbledhje të të hyrave.

6. Siç është arritur marrëveshja për përfundimet e MIK, të gjitha informatat dhe provat e grumbulluara për zbatimin e operacioneve të lartcekura do të ndahen bashkërisht në mes të Palëve dhe sipas dokumenteve nga Marrëveshja e MIK-ut, përfshirë dhe Marrëveshjen Teknike.

### B. Fondi Zhvillimor

7. Fondi Zhvillimor (që këtej e tutje Fondi) duhet të krijohet për të promovuar zhvillimin socio-ekonomik dhe për të mirën e popullsisë lokale në Leposaviq, në veri të Mitrovicës, Zubin Potok dhe Zveçan.

8. Funkzioni i Fondit do të vendoset nga Bordi Menaxhues. Bordi Menaxhues do të jetë i përbërë nga tre anëtarë, një përfaqësues i komunitetit Serb i cili jeton ose në Leposaviq, veri të Mitrovicës ose Zubin Potok ose Zveçan, një përfaqësues nga autoritetet Kosovare dhe Përfaqësues Special nga Bashkimi Evropian për Kosovë (PSBE). PSBE-ja do të ftojë përfaqësuesit e lartcekur pas konsultimeve me palët e interesuara në Fond. Bordi Menaxhues do të vendos me konsensus. Në rast të paafësisë së përsëritur të arritjes së konsensusit, PSBE-ja mund të përdor votën vendimtare për të përkrahur qëllimin e Fondit, përfshirë edhe miratimin e Kushteve e përkohshme të Referencës.

9. Të hyra të grumbulluara në ZPKD-të në Jarinjë/Rudnica dhe Tabavijë/Bërnjak do të transferohen në llogarinë e Fondit të krijuar në një bankë komerciale në Prishtinë të caktuar nga BE.

### C. Dispozitat kalimtare:

10. Palët më tutje pajtohen që brenda 3 ditëve të hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, zyrtarët Kosovar dhe të EULEX-it duhet të kenë qasje të papenguar në ZPKD, përfshirë përmes rrugës, në lidhje me këtë marrëveshje dhe përfundimet e mëparshme mbi MIK. Çdo përpjekje e mundshme, përfshirë edhe përmes deklaratave publike në nivelin më të lartë politik, do të bëhen në këtë nivel.

11. Brenda 7 ditëve pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, Fondi do të themelohet me iniciativën e PSBE-së i cili do të bëjë hapjen e llogarisë bankare të lartcekur.

12. Grumbullimi i detyrimeve doganore dhe të akcizës e poashtu edhe TVSH-së në ZPKD në Jarinjë/Rudnica dhe Tabavijë / Bërnjak do të fillojë menjëherë pas themelimit të Fondit. Autoritetet Kosovare do të sigurojnë që dokumentacioni i lëshuar (forma e përkohshme) për kompanitë dhe ndërmarrjet do të përmbajë informacione specifike mbi paracaktimin e të hyrave.

<sup>5</sup> Siç është përcaktuar nga Akti i Përbashkët i Këshillit 2008/124 CEFSP, Neni 3, Pjesa a

13. Brenda 30 ditëve pas hyrjes së në fuqi të kësaj marrëveshjeje, Palët do të kenë miratuar rregulloret e nevojshme për të zbatuar këtë marrëveshje dhe do të kenë shfuqizuar rregulloret që janë në kundërshtim me marrëveshjen e lartcekur.

14. Nuk do të ketë shpagim të të hyrave të deponuara në Fond derisa Palët të vendosin ndryshe.

15. Përgatitjet për regjistrim janë në baza të përkohshme.

D. Dispozitat finale:

16. Kjo Marrëveshje do të hyj në fuqi më 19 janar 2013 në ora 00:00.

17. Zbatimi i marrëveshjes do të rishikohet nga grupi punues monitorues (GP) i kryesuar nga BE-ja dhe i përbërë nga Palët. GP kryesisht do të koncentrohet në sigurimin e procesit të regjistrimit sipas paragrafëve 4 dhe 5 të cilat do të jenë të dobishme vetëm për këtë marrëveshje.

**(përkthim jo zyrtar)**



## KONKLUZIONET

Takimi për SEED, Romë Itali, 24 janar 2013

**Në harmoni me Protokollin Teknik për implementimin e MIK<sup>1</sup> konkluzionet e dakorduara nga Dialogu me datën 2 dhjetor 2011 dhe Plani Final i Veprimit për Grupin Implementues (GI) për Protokollin Teknik mbi MIK – 4 dhjetor 2012, ku janë arritur konkluzionet si në vijim:**

1. Të dyja Palët (siç është përcaktuar në Protokollin Teknik për implementimin e MIK konkluzionet e dakorduara nga Dialogu me datën 2 dhjetor 2011) pajtohen për implementimin e sistemit SEED për shkëmbimin elektronik të të dhënave.
2. Të dyja Palët janë pajtuar që të shkëmbejnë të dhëna të cilat aktualisht janë në kompetencat e tyre Doganore, që në ç' rast se njëra nga Palët (Beogradi) nënkuptohet vetëm deklarata të transitit, përfshirë TIR dhe ATA carnet.
3. Opsioni për përpunimin e të dhënave përmes një serveri të vetëm të mesëm është opsioni që preferohet nga të dyja Palët.
4. Sa i përket lokacionit të serverit të mesëm, të dyja Palët janë pajtuar për lokacione tjera përveç Beogradit dhe/ose Prishtinës:
  - Propozimi i parë i dakorduar nga të dyja Palët që lokacioni i serverit të mesëm të jetë brenda Komisionit Evropian në Bruksel;
  - Opsioni i dytë i preferuar për lokacionin e serverit të mesëm të jetë brenda Agjencisë Doganore të Italisë (ADI) (agjencia implementuese e projektit të SEED) në Romë – ky propozim është mbështetur plotësisht nga Drejtori i Përgjithshëm i ADI, i cili i ka siguruar të dyja Palët që e gjithë ndihma e nevojshme për të garantuar mbrojtjen e pajisjeve dhe të dhënave do të sigurohet;
  - Opsioni i tretë është të kontrollohet mundësia që serveri i mesëm të jetë në njërin nga Zyrat e BE-së për Delegim në Rajon, përveç në Beograd dhe/ose në Prishtinë;

Vendimi mbi lokacionin e serverit të mesëm do të merret nga Ndërmjetësi Kryesor i BE-së për MIK dhe në diskutim me anëtarët e GI gjatë vizitave të afërta në Beograd dhe Prishtinë gjatë javës së ardhshme.
5. Brenda 7 ditësh së pranimit të vendimit për lokacionin e serverit të mesëm, ekipi për Projektin SEED pajtohen që të krijojnë një Plan Veprimi për implementim, për të përfshirë aktivitetet, periudhat kohore dhe buxhetin.
6. Për të siguruar financat për implementimin e shkëmbimit të të dhënave SEED, Ndërmjetësi i Marrëveshjes së BE-së për MIK kërkohet që të dërgoj një kërkesë formale për DP për Zgjerim.

<sup>1</sup> Njëra Palë e njeh vijën si kufi; dhe Pala tjetër e njeh vijën si kufi administrativ.

## MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT

Në frymën e marrëveshjes së Brukselit nga data 19 prill 2013 dhe

Ndërmjet Shoqatës së Siguruesve Serbë (SHSS) dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS), si entitete të autorizuara përgjegjëse për çështjet e sigurimit të automjeteve në juridiksionin e secilës palë, me facilitimin e Këshillit të Byrosë (KB), dhe

Për Njohjen Reciproke të Sigurimit nga Autopërgjegjësia për Palët e Treta (TPL) dhe marrëveshje për procesimin dhe pagesën e kërkesave.

**DUKE PASUR PARASYSH QË:**

SHSS dhe BKS dëshirojnë të ofrojnë marrëveshje për:

- a) njohjen reciproke dhe pranimin e TPL valide, dhe
- b) procesimin dhe pagesën e dëmeve si pasojë e aksidenteve të shkaktuara nga automjetet me mbulim të vlefshëm sigurues në juridiksionin e secilës palë.
- c) zbatimin i këtij MM nën juridiksionin e secilës palë.

SHSS dhe BKS janë pajtuar si në vijim:

### I. DEFINICIONET

Për qëllime të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit (MM):

“Byroja për Trajtime” nënkupton SHSS-në, BKS-në apo çfarëdo anëtar të autorizuar- kompani të sigurimit ose ndonjë entitet tjetër ligjor, i cili lejohet të trajtoj dhe zgjidh kërkesat sipas dispozitave të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit dhe i cili kërkon rimbursim nga një kompani e sigurimeve që është anëtare e SHSS-së apo BKS-së, sipas kushteve të këtij MM.

“Byroja Garantuese” nënkupton byronë, qoftë SHSS apo BKS, e cila garanton kërkesat për rimbursim të paguara nga Byroja për Trajtim sipas procedurave të përcaktuara në këtë MM dhe kërkesave në emër të anëtarëve të saj nën likuidim apo falimentim.

“Siguruesi” nënkupton çfarëdo kompanie të sigurimeve, anëtare e SHSS ose BKS, e cila është e autorizuar/licencuar për zhvillimin e biznesit për sigurim të detyrueshëm ndaj palës së tretë në lidhje me përdorimin e automjetit në juridiksionin e secilës palë, e cila ka lëshuar policën e sigurimit për automjetin që ka shkaktuar dëmin.

### II. MBULIMI RECIPROK – TPL

1. Përdoruesit e mjeteve motorike të regjistruara në njërën palë, të cilët posedojnë sigurinë vlefshëm për territorin e palës tjetër, mund të hyjnë lirish dhe të udhëtojnë në atë juridiksion. Kopja e mostrës së secilës policë të sigurimit (TPL e lëshuar nga SHSS, TPL + e lëshuar nga BKS) i është bashkangjitur këtij Memorandumi si Shtojca I.
2. Në rast se përdoruesit e mjeteve motorike të njërës palë nuk paraqesin sigurim të vlefshëm me rastin e hyrjes në juridiksionin e palës tjetër, atëherë ata janë të obliguar të kontraktojnë një sigurim të detyrueshëm kufitar/në kufi.
3. Kontrolli i posedimit dhe vlefshmërisë së mbulesës siguruese do të bëhet në pikat kufitare të MIK-ut. Të dy palët do të krijojnë pikat e kontakteve në mënyrë që menjëherë të verifikohet mbulesa siguruese në rast dyshimi. Një verifikim elektronik mund të vendoset në pikat kufitare të MIK-ut për kontroll të posedimit dhe vlefshmërisë së mbulesës siguruese.
4. Dëmi i shkaktuar nga përdorimi i mjeteve motorike pa sigurim të vlefshëm në juridiksionin e palës tjetër do të rimburohet nga fondet garantuese të palës ku ka ndodhur aksidenti. Në qoftë se njëra nga palët nuk ofron verifikimin elektronik të përmendur më lart, ajo palë duhet të garantojë rimbursimin e kërkesave që dalin nga aksidentet e shkaktuara nga automjetet e pasiguruara nga juridiksioni i saj.
5. Kërkesat nga palët e dëmtuara të shteteve të treta do të trajtohen si kërkesa nga palët e dëmtuara vendore.
6. Limitet e kompensimit të sigurimit (shih Shtojcën II) do të konsiderohen të vlefshme deri në shkëputjen e këtij MM apo njoftimin nga njëra palë, në rast të ndryshimeve legislative.
7. Secila palë duhet të informojë palën tjetër përmes një njoftimi të mjaftueshëm për çfarëdo ndryshimi ligjor që ka të bëjë me fushëveprimin e këtij MM.

### III. TRAJTIMI DHE KOMPENSIMI I KËRKESAVE

1. Një listë fillestare e emrave dhe adresave të kompanive të sigurimit që janë anëtare të Byrosë përkatese i është bashkangjitur këtij MM (shih Shtojcën III). Secila palë duhet ta njoftojë menjëherë palën tjetër për çfarëdo ndryshimi brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve për njohuritë e tyre për çfarëdo ndryshimi.

2. Të gjitha kërkesat duhet të trajtohen nga Byroja për Trajtim në lidhje me dispozitat ligjore dhe rregullative që janë të zbatueshme në juridiksionin ku ka ndodhur aksidenti, në lidhje me përgjegjësinë dhe kompensimin e palëve të dëmtuara.
3. Në këtë MM përfshihen raportimi, trajtimi dhe pagesa e kërkesave për lëndimin personal, apo për humbje ose dëmtim të pasurisë që ka ndodhur si pasojë e ndonjë aksidenti në juridiksionin e njëres palë, të shkaktuar nga automjetet e regjistruara dhe të siguruara në palën tjetër me një sigurim të vlefshëm sipas Shtojcës I.
4. Në rast të aksidentit, Byroja për Trajtime është e obliguar që menjëherë ta njoftoj Byronë Garantuese/Siguruesin për të gjitha kërkesat dhe duhet të veproj në interesat më të mira të Byrosë Garantuese/Siguruesit sikur vetë ta kishte lëshuar sigurimin.
5. Pasi që të paguhet kompensimi, Byroja për Trajtim është e obliguar t'i dërgoj Byrosë Garantuese/Siguruesit të gjitha dokumentet e nevojshme për arsyetimin e pagesës. Kjo duhet të përfshijë edhe raportin e policisë, i cili përmban të dhënat mbi pjesëmarrësit në aksidentin në fjalë (duke përfshirë edhe deklaratat e dhëna direkt nga palët si shtesë të raportit të policisë), fotografitë vendit të aksidentit dhe automjetit të dëmtuar, ekspertizën profesionale sa i përket vlerësimit të dëmit, dokumentacionin mjekësor (siç kërkohet në rregullat e organeve rregullative përkatëse dhe me respektimin e duhur të parimeve të mbrojtjes së të dhënave), së bashku me një kopje të dëshmisë së sigurimit të vlefshëm, sipas Shtojcës I. Raporti i policisë duhet të ofrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke përfshirë përdorimin e gjuhës në juridiksionin e secilës palë. Byroja për Trajtim duhet ta informojë Byronë Garantuese/Siguruesin nëse përdoruesi i mjetit motorik nuk e ka nënshkruar raportin e policisë.

Për aksidentet që ndodhin brenda kufirit prej pesëdhjetë (50) kilometrave (sipas koordinatave të GPS) të kufirit/kufitare, duhet të tregohet nëse shoferi ka kërkuar praninë e një polici që flet gjuhën amtare dhe nëse ky i fundit e ka nënshkruar raportin i policisë.

6. Dispozitat e këtij MM nuk do të zbatohen për raportet e aksidenteve motorike të rëna dakord reciprokisht (constat amiable).

#### IV. TRAJTIMI I KËRKESAVE

1. Byroja Garantuese/Siguruesi është e obliguar të rimburojë tek Byroja për Trajtime e Palës tjetër shumën e tërësishme të kompensimit të paguar nga Byroja për Trajtime e palës tjetër në lidhje me kërkesën në kuadër të MM, si dhe tarifat e trajtimit si dhe të

gjitha kostot tjera të shkaktuara gjatë trajtimit të kërkesës, siç paraqitet në paragrafin 2 dhe 3 më poshtë.

2. Tarifat e trajtimit të Byrosë për Trajtime llogariten sipas normës 15% të shumës totale të kompensimit, subjekt i tarifës minimale të trajtimit prej 200.00 Euro, ndërsa ajo maksimale 3,500.00 Euro.
3. Shumat e disbursuara për shërbime të jashtme në trajtimin dhe zgjidhjen e çdo kërkesë dhe të gjitha kostot e shkaktuara specifikisht për arsye të veprimit ligjor, të cilat do të ishin disbursuar në rrethana të ngjashme nga një sigurues i themeluar në juridiksionin e aksidentit, në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenin 5.1.2 e Rregulloreve të Brendshme të Këshillit të Byrosë.
4. Tarifat minimale të trajtimit duhet të bëhen edhe kur kërkesa trajtohet pa pagesë ndaj palës së tretë.
5. Këmbimi ndërmjet valutave për të gjitha pagesat e detyruara në pajtim me këtë MM do të jetë kursi i mesëm zyrtar i këmbimit, në ditën kur kërkesa për rimbursim është paraqitur nga Byroja për Trajtime i tek Byroja Garantuese/Siguruesi.
6. Pas kompletimit të trajtimit të kërkesës përmes sigurimit të "Formularit të pagesës" nga ana e paraqitësit të kërkesës me të cilën vërtetohet zgjidhja e plotë dhe përfundimtare apo zgjidhja e aprovuar e pjesës jokontestuese të kërkesës dhe ekzekutimi i pagesës së kërkesës:

Për kërkesat që dalin nga aksidentet në një juridiksion, Byroja për Trajtim e atij juridiksioni, korrespondenti ose agjenti i cili trajton ankesën duhet, brenda maksimum dymbëdhjetë (12) muajve nga data e pagesës së fundit ndaj paraqitësit të kërkesës, ta njoftoj drejtpërdrejt Byroën Garantuese/Siguruesin në lidhje me kërkesën e proceduar dhe paguar, së bashku me llogaritjen e dëmit dhe komplet dokumentacionin përkatës, siç është përcaktuar më sipër. Në rast se kërkesa për rimbursim i komunikohet Byrosë Garantuese/Siguruesit pas 12 muajve, një kërkesë e tillë për rimbursim mund të refuzohet nga Byroja Garantuese/Siguruesi dhe nuk do t'i nënshtrohet garancive nga Byroja Garantuese.

Byroja Garantuese/Siguruesi, pas pranimit të kërkesës për rimbursim brenda afatit prej 60 ditësh nga paraqitja e kërkesës, duhet të kryej pagesën e kërkesës për rimbursim ndaj Byrosë për Trajtim.

Në rast se kërkesa për rimbursim nuk shlyhet brenda 60 ditëve nga data kur për herë të parë është paraqitur kërkesa për rimbursim, Byroja Garantuese/Siguruesi duhet të paguaj interesin ndëshkues në normën prej 12% në vit, llogaritur nga data kur për

herë të parë është paraqitur kërkesa e tillë deri në datën e pranimit të remitencës nga Byroja për Trajtim.

Nëse brenda afatit prej 60 ditësh nga data e kërkesës së parë për rimbursim siguruesi dështon të bëjë pagesën ndaj Byrosë për Trajtim, Byroja për Trajtime mund përmes SHSS apo respektivisht BKS, brenda afatit kohorë prej maksimum 12 muajsh nga data kur është paraqitur kërkesa për rimbursim, të kërkoj nga Byroja Garantuese rimbursimin e shumës në fjalë. Në rast se kërkohet përfshirja e Byrosë Garantuese pas kalimit të afatit kohor prej 12 muajsh, një kërkesë e tillë mund të hedhet poshtë (refuzohet) nga Byroja Garantuese.

Byroja Garantuese, pas pranimit të kërkesës për rimbursim, duhet që brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga data e paraqitjes së kërkesës t'ia paguaj Byrosë për Trajtim kërkesës për rimbursim.

Nëse brenda periudhës prej tridhjetë (30) ditësh nga data kur për herë të parë është paraqitur kërkesa për rimbursim Byroja Garantuese nuk ka kryer pagesën ndaj Byrosë për Trajtim, Byroja për Trajtim mund që përmes SHSS apo respektivisht BKS, të kërkoj një intervenim nga Këshilli i Byrosë, duke përfshirë edhe aktivizimin e garancive, nëse është e nevojshme.

7. Shkëmbimi i dokumentacionit duhet të bëhet në formë elektronike dhe/ose kopje fizike.

## V. KORRESPONDENTI

1. Byroja Garantuese, në emër të njërit nga anëtarët e saj, mund t'i kërkoj Byrosë për Trajtim që trajtimi dhe zgjidhja e kërkesave, përfshirë tarifat e trajtimit, të kryhet nga korrespondenti i cili mund të jetë:
  - një anëtar i Byrosë për Trajtime
  - një organizatë e themeluar në territorin e Byrosë për Trajtime dhe e specializuar, në emër të siguruesve, në trajtimin dhe zgjidhjen e kërkesave që shkaktohen nga aksidentet me mjete motorike.
2. Nëse Byroja për Trajtime miraton kërkesën, ajo i jep autoritet korrespondentit të caktuar të trajtoj dhe zgjidh kërkesat në emër të saj. Ajo merr përsipër informimin e palëve të treta për këtë autoritet dhe përcjelljen e të gjitha njoftimeve në lidhje me kërkesat e tilla tek korrespondenti.

3. Sipas nenit 4.1 të Rregullores së Brendshme të KIB, miratimi i një korrespondenti jepet automatikisht kur kërkohet në emër të një anëtari të Byrosë Garantuese për çdo themelim të këtij anëtari në juridiksionin e Byrosë për Trajtime, me kusht që themelimi i tillë është i autorizuar të bëjë sigurimin ndaj përgjegjësisë civile në lidhje me përdorimin e mjeteve motorike.
  4. Nëse Byroja për Trajtime nuk përgjigjet brenda tre (3) muajve nga dita e marrjes së kërkesës për emërim, emërimi i korrespondentit do të konsiderohet si i vlefshëm dhe në fuqi.
  5. Nga ana e tij, anëtari i Byrosë Garantuese, në kërkesën për emërimin e një korrespondenti të propozuar, merr përsipër besimin e të gjitha kërkesave në territorin e aksidentit tek ai korrespondent dhe përcjelljen të gjithë dokumentacionit përkatës të kërkesave të tilla tek ai korrespondent.
  6. Si një agjent i Byrosë për Trajtim i autorizuar në mënyrë të rregullt, agjenti i propozuar bëhet përgjegjës për këtë byro për trajtimin e kërkesës dhe duhet të marrë parasysh çfarëdo udhëzime, qoftë të përgjithshme ose të veçanta, të pranuar nga Byroja për Trajtim.
  7. Anëtari i Byrosë Garantuese duhet ta siguroj Byronë për Trajtim se korrespondenti i tij do të zgjidh kërkesat në përputhje të plotë me dispozitat e palës së tretë të Ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia të Byrosë për Trajtim.
  8. Byroja për Trajtim mund, në çdo kohë dhe pa qenë e nevojshme të jep ndonjë arsye, ta marrë përsipër trajtimin e çfarëdo kërkesë dhe t'ia revokojë autoritetin korrespondentit për atë kërkesë në veçanti apo në përgjithësi.
  9. Roli i korrespondentit është pa paragjykimë ndaj përfshirjes së Këshillit të Byrosë në zgjidhjen e kërkesave.
- VI. Këshilli i Byrosë – KIB
1. Me kërkesë të SHSS, BKS apo në rast të ankesave nga palët e treta, KIB duhet të ofrojë asistencë, ndërmjetësim dhe arbitrim gjatë zbatimit të këtij MM.
  2. SHSS dhe BKS dakordohen t'ia besojnë KIB zgjidhjen e kontesteve në përputhje me rregullat e KIB për ndërmjetësim dhe të rregulloreve të brendshme. Në rast të mos-përputhjes me vendimet e KIB me pasoja serioze financiare, pala ka të drejtë të shkëpusë MM në përputhje me Nenin IX, 2.

3. SHSS dhe BKS dakordohen ta ofrojnë në gjuhën Angleze të gjithë dokumentacionin e domosdoshëm në rast të kontestit, duke përfshirë dëshmitë e pagesave dhe një kopje të kërkesës për rimbursim.
4. SHSS dhe BKS dakordohen t'i konsiderojnë vendimet në përputhje me rregullat e KIB për ndërmjetësim dhe arbitrim si përfundimtare dhe të veprojnë sipas rrethanave.
5. Kontestet për shumën nën 500 € nuk do të paraqiten tek KIB.
6. Me iniciativë të KIB do të shqyrtohet zbatimi i këtij MM dhe përgjegjësitë e KIB në veçanti.
7. KIB mund të ftojë SHSS dhe BKS për shqyrtimin e pjesëve të MM dhe në mënyrë të njëanshme mund të përfundojë pjesë apo të gjitha përgjegjësitë e saj nën këtë MM, me një periudhë të njoftimit prej gjashtë (6) muajve, me ç'rast MM do të shkëputet në fund të periudhës së njoftimit.

## VII. GARANCIA

1. SHSS dhe BKS do t'i ofrojnë garanci KIB.
2. KIB do t'i konfirmojë SHSS dhe BKS pranimin e garancive të ofruara.
3. Në rast të shkëputjes së këtij MM, garancitë do të mbesin deri në zgjidhjen e të gjitha kërkesave.

## VIII. KOMITETI PËR ZBATIM

1. Do të themelohet komiteti për zbatim i përbërë nga anëtarët në vijim:
  - Kryetari i secilës byro/shoqatë;
  - Sekretari i përgjithshëm i secilës byro/shoqatë;
  - Në maksimum tre ekspertë shtesë të secilës byro/shoqatë.
2. Takimet e komitetit për zbatim do të mbledhen me kërkesën e cilësdo palë dhe duhet të zhvillohen së paku një herë në vit. Koha dhe vendi i takimit duhet të dakordohen në mënyrë të ndërsjellë.
3. Me kërkesë të SHSS, BKS apo me vetë iniciativë, KIB mund të marrë pjesë në komitetin për zbatim. Palët do ta informojnë KIB për takimet e komitetit për zbatim, agjendën e tij dhe do të ofrojnë kopje të rezultatit të procedurave.



4. Shkëmbimi i dokumentacionit duhet të bëhet në formë elektronike dhe/apo kopje fizike.

#### IX. HYRJA NË FUQI DHE SHKËPUTJA E MM-SË

1. Ky MM hyn në fuqi tridhjetë (30) ditë pas nënshkrimit nga SHSS dhe BKS.
2. SHSS apo BKS mund ta shkëpusë këtë MM përmes dorëzimit të njoftimit me shkrim për shkëputje së paku gjashtëdhjetë (60) ditë përpara tek byroja tjetër. Kur njoftimi me shkrim dërgohet me postë, ai konsiderohet të jetë dorëzuar në datën kur është dërguar njoftimi, siç verifikohet me vulën zyrtare postare.
3. Kërkesa që del nga një aksident që ndodh para datës së skadimit të sigurimit të përdoruesit të mjetit motorik të përfshirë, duhet të trajtohet dhe paguhet në përputhje me dispozitat e këtij MM, vetëm nëse aksidenti ka ndodhur para datës së shkëputjes së këtij MM.

#### X. MONITORIMI DHE MBIKËQYRJA

1. Monitorimi dhe mbikëqyrja e implementimit të këtij MM do të bëhet nga organet e autorizuar në përputhje me Rregulloret ligjore në fuqi.

#### XI. GJUHA

1. Çfarëdo korrespondence ndërmjet palëve në këtë MM, qoftë verbale apo me shkrim, në lidhje me dispozitat e këtij MM, duhet të kryhet në gjuhën Angleze.

E nënshkruar në Bruksel më 23 qershor 2013, me tri (3) kopje origjinale në gjuhën Angleze.

Në emër të Byrosë Kosovare të Sigurimeve (BKS)

Z. Faton Abazi

Drejtor [nënshkruar] [vulosur]

Sj dëshmitarë:

[nënshkruar]  
Znj. Greet Floré  
Sekretare e Përgjithshme  
e Këshillit të Byrove

[nënshkruar]  
Znj. Edita Tahiri  
Ministrja për Dialog,  
Kosovë

[nënshkruar]  
Z. Rrahim Pacolli  
Shefi Kuvendit të  
Siguruesve të Kosovës





Shtojca II  
LIMITET E KOMPENZIMIT TË SIGURIMIT

Ligji Nr. 04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia në Kosovë

Neni 13-Kufizimi i mbulesës siguroese – limitet e sigurimit.

1. Detyrimi i siguroesit nga kontrata e sigurimit të autopërgjegjësisë është i kufizuar me shumën e detyrueshme të sigurimit e vlefshme sipas ligjit, në ditën e aksidentit, përveç kur është kontraktuar një shumë më e lartë e sigurimit.
2. Shuma e detyrueshme minimale e sigurimit për kontraktimin e sigurimit të autopërgjegjësisë, sipas paragrafit 1. të këtij neni, është si më poshtë:
  - 2.1 për dëme në persona, për rast të siguar, pavarësisht nga numri i personave të dëmtuar një milion (1.000.000) Euro
  - 2.2 për dëme në pasuri, për rast të siguar, pavarësisht nga numri i personave të dëmtuar dyqind mijë (200.000) Euro
  - 2.3 për dëme të shkaktuara nga përdorimi i autobusit dhe mjeteve motorike të destinuara për transportin e lendeve të rrezikshme, zbatohet dyfishi i shumave minimale të sigurimit të përcaktuara në nën-paragrafët 2.1. dhe 2.2. të këtij paragrafi.
3. Në rast se ka disa palë të dëmtuara nga një ngjarje dhe vlera totale e dëmit e tejkalon shumën e sigurimit të përcaktuar në paragrafin 2. të këtij neni, të drejtat e palëve të dëmtuara ndaj siguroesit zvogëlohen në mënyrë përpjesëtimore.
4. Vendimin mbi ndryshimin e lartësisë së shumave minimale të sigurimit e miraton Qeveria e Republikës së Kosovës, me propozimin e BQK-së. Ky ndryshim i shumave publikohet në gazetën zyrtare të Kosovës.
5. BQK-ja përcakton për siguroesit kornizat e kontraktimit të mbulesës siguroese mbi shumën minimale të sigurimit.

Sipas Nenit 22 të Ligjit për sigurimin e detyrueshëm të trafikut, limitet e TPL të sigurimit (shumat minimale të mbulesës siguroese) në Serbi janë si në vijim:

- |                              |                              |
|------------------------------|------------------------------|
| 1. Dëmtime personale         | 1.000.000 Euro për aksident. |
| 2. Humbje/dëmtim të pasurisë | 200.000 Euro për aksident.   |

**LISTA E EMRAVE DHE ADRESAVE TË KOMPANIVE TË SIGURIMIT QË JANË ANËTARE TË BKS DHE SHSS**

Për BKS:

- 1. Kompania e Sigurimeve ILLYRIA**  
Sheshi Nëna Terezë, Nr. 33  
10000 Prishtinë – Kosovë  
Remzi Shala – Drejtor i Departamentit të Dëmeve
  
- 2. Kompania e Sigurimeve KOSOVA E RE**  
“Agim Ramadani,” Nr. 1  
10000 Prishtinë – Kosovë  
Halim Mujku - Drejtor i Departamentit të Dëmeve
  
- 3. Kompania e Sigurimeve SIGURIA**  
“Luan Haradinaj” L.l.a  
10000 Prishtinë – Kosovë  
Xhavit Pacolli - Drejtor i Departamentit të Dëmeve
  
- 4. Kompania e Sigurimeve INSIG**  
Q. Pejton, rruga “Pashko Vasa,” Nr. 6  
10000 Prishtinë – Kosovë  
Engjell Gina - Drejtor i Departamentit të Dëmeve
  
- 5. Kompania e Sigurimeve SIGAL**  
Dega Drini në Kosovë  
Rruga e “UÇK” Nr. 60  
10000 Prishtinë – Kosovë  
Kimeti - Drejtor i Departamentit të Dëmeve
  
- 6. Kompania e Sigurimeve CROATIA SIGURIMI**  
“Fehmi Agani” 69 D/1-2  
10000 Prishtinë – Kosovë  
Nexhmedin Asllani - Drejtor i Departamentit të Dëmeve
  
- 7. Kompania e Sigurimeve DARDANIA**  
“Nëna Terezë”  
10000 Prishtinë – Kosovë

Muhamed Boja - Drejtor i Departamentit të Dëmeve

**8. Kompania e Sigurimeve ELSING**

Rruga e Trepçës, Nr. 15  
10000 Prishtinë – Kosovë  
Qerim Aliqka - Drejtor i Departamentit të Dëmeve

**9. Kompania e Sigurimit SIGKOS**

Sylejman Vokshi, Pallati i Kuq  
10000 Prishtinë – Kosovë  
Agim Hoxha - Drejtor i Departamentit të Dëmeve

**10. Kompania e Sigurimeve SIGMA**

Dega "SIGMA"  
Pashko Vasa, p. n.  
10000 Prishtinë – Kosovë  
Bali Mahmuti - Drejtor i Departamentit të Dëmeve

**11. Kompania e Sigurimeve PRISIG SILA**

"Fazli Grajçevci"  
10000 Prishtinë – Kosovë  
Tel.: +381 38 221 000  
[www.prisig-ks.com](http://www.prisig-ks.com)

**12. Kompania e Sigurimeve SCCARDIAN JSC**

"Anton Çetta," 5a  
10000 Prishtinë – Kosovë  
Tel.: +381 38 777 444  
+386 49 90 90 90  
[indo@scardian.com](mailto:indo@scardian.com)  
[www.scardian.com](http://www.scardian.com)

Insurer	Code	Address	Phone	Fax	e-mail	website
anje a.d.o.	SRB-AM	Ruzvelova 16, 11000, Beograd	+381113433530	+381113433593	zelena.karta@sams.co.rs	www.gms.co.rs
je a.d.o.	SRB-AS	Bul. Mihajla Pupina 165c, 11070 Novi Beograd	+381112608676	+381113608684	info@ai-osiguranje.rs	www.ai-osiguranje.rs
ano osiguranje a.d.o.	SRB-AX	PC Urke - Bulevar Mihajla Pupina 6, 11070 Novi Beograd	+381112200420	+381112200491	nikola.ilk@aca.rs	www.aaa.rs
i Sad a.d.o.	SRB-NS	Bul. Mihajla Pupina 8, 21000 Novi Sad	+381216616072	+381216624831	wina.zepina@dodor.co.rs	www.dodor.co.rs
ranje a.d.o.	SRB-D	Mekenzijeva 65, 11000 Beograd	+381112441725	+381112431780	greencard@dinov.com	www.dinovy.com
iguranja Slobija a.d.o.	SRB-G	Vladimira Popovica 8, 11000 Beograd	+381113110864	+381113113256	greencard@generali.rs	www.generali.rs
osiguranje a.d.o.	SRB-ML	Bulevar Mihajla Pupina 10 L, 11070 Novi Beograd	+381117152300	+381117152300	mls@milinjum-osiguranje.rs	www.milinjum-osiguranje.rs
ranje a.d.o.	SRB-SV	Bul. Vojvode Miste 51, 11000 Beograd	+381113644801	+381113644889	office@sava-osiguranje.rs	www.sava-osiguranje.rs
iguranje a.d.o.	SRB-TO	Mihajla Milankovica 7a, 11000 Beograd	+381113404918	+381113122400	biljana.termanovic@trifol.rs	www.trifol.rs
vojno osiguranje a.d.o.	SRB-UQ	Mihajla Milankovica 134g, 11000 Beograd	+381117934100	+381112024142	info.stete@unika.rs	www.unika.rs
aditshe osiguranje a.d.o.	SRB-WS	Tresnjing Cveta 1, 11070 Novi Beograd	+381112209999	+381112120196	office@wiener.co.rs	www.wiener.co.rs
of Serbian Insurers osiguravaca Srbije	UOE ASI	Milena Popovica 5b/II, Novi Beograd	+381112927900 +381112927950	+381112927900	greencard@uoe.rs	www.uoe.rs

## KONKLuzionet e Kryesuesit

## Marrëveshjet ndërlidhëse

Të dy palët u takuan më datat 28-29 janar, 5 shkurt, 14 shkurt, 5-6 mars, 11 mars, 9 maj dhe 30 maj të vitit 2013 për të shkëmbyer pikëpamjet mbi marrëveshjet ndërlidhëse.

Ata shqyrtuan modalitetet e propozuara nga BE-ja në lidhje me pritjen e Zyrtarit Ndërlidhës dhe stafit të tij në Delegacionin e BE-së/Zyrën e BE-së.

Përveç kësaj, ata ranë dakord që dispozitat e mëposhtme do të zbatohen për Zyrtarin Ndërlidhës dhe stafin e tij:

**Preambula:** Në kontekstin e perspektivës evropiane për Ballkanin Perëndimor, Beogradi dhe Prishtina janë angazhuar në hapat e mëtejme që shpijnë drejt normalizimit të marrëdhënieve mes dy palëve. Në dhjetor të vitit 2012, Këshilli i BE-së gjithashtu mirëpriti vendimin për të emëruar persona ndërlidhës të cilët do të duhej të vendoseshin në zyra të ofruara nga Delegacioni i BE-së në Beograd dhe Zyra e BE-së në Prishtinë të cilët do të ndjekin të gjitha çështjet që lidhen me normalizimin e marrëdhënieve dhe do të adresojnë problemet e përditshme që mund të ndodhin. Bashkimi Evropian ofron lehtësim për të arritur këto aranzhime dhe për të ndihmuar në zbatimin e tyre në përputhje me praktikën më të mirë të BE-së.

Shkëmbimi i Zyrtarëve Ndërlidhës do të fillojë më 15 qershor 2013.

1. Zyra e përdorur nga Zyrtari Ndërlidhës dhe stafi i tij në kuadër të Delegacionit të BE-së/Zyrës së BE-së, si dhe arkivat dhe dokumentet që ata përdorin, duke përfshirë edhe korrespondencën zyrtare, do të gëzojnë paprekshmëri.



2. Rezidenca private e Zyrtarit Ndërlidhës dhe stafit të tij do të jetë e paprekshme. Të dy palët do të ofrojnë mbrojtje të objekteve 24/7.
3. Pala përkatëse do t'i ofroj Zyrtarit ndërlidhës dhe stafit të tij liri të lëvizjes dhe udhëtimit, e cila është në përputhje me marrëveshjen për liri të lëvizjes e arritur në dialogun e datës 2 korrikut 2011.
4. Paprekshmëria dhe mbrojtja personale. Të dyja palët do të ofrojnë mbrojtje personale për Zyrtarin Ndërlidhës dhe për stafin e tij 24/7.
5. Procedurat penale, civile dhe administrative kundër Zyrtarit Ndërlidhës dhe asistentit të tij do të kryhen vetëm para Gjykatës dhe autoriteteve tjera të juridiksionit të Palës së Zyrtarit Ndërlidhës dhe asistentit. Zyrtari Ndërlidhës dhe asistenti nuk do të jenë subjekt i paraburgimit, arrestimit apo të detyrohen të japin dëshmi si dëshmitar.  
  
Shoferi do të përfitojë nga dispozitat e mëparshme, përveç nëse këto dispozita që kanë të bëjnë me procedurat civile dhe administrative nuk do të zgjerohen në veprimet e kryera jashtë detyrave të tij.
6. Zyrtari Ndërlidhës dhe stafi i tij do të paguajnë të gjitha taksat dhe detyrimet mbi të ardhurat të ndërlidhura me detyrat e tyre për Palën e tyre përkatëse.
7. Pala përkatëse do të lejojë hyrjen e granteve dhe lirimim e tyre nga të gjitha detyrimet doganore, taksat dhe tarifatat që kanë të bëjnë me:
  - a. artikujt për përdorim zyrtar të Zyrtarit Ndërlidhës ose të stafit të tij;
  - b. artikujt për përdorim personal të Zyrtarit Ndërlidhës ose të stafit apo për anëtarët e familjes së tij.
8. Pas njoftimit 24 orësh, të dy palët do të ofrojnë procedura preferenciale të hyrjes/daljes, përjashtim nga inspektimi i bagazheve personale si dhe mbrojtje personale.

9. Anëtarët e familjes së Zyrtarit Ndërlidhës dhe stafit të tij (bashkëshortja dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare), që janë pjesë e familjes së tyre do t'i gëzojnë të njëjtat kushte të specifikuar në paragrafët 3, 5, 6 dhe 8 me përjashtim të mbrojtjes personale. Në këtë aspekt:

Procedurat penale, civile dhe administrative kundër familjes së Zyrtarit Ndërlidhës dhe asistentit të tij që janë pjesë e familjeve të tyre përkatëse, do të bëhen kryhen vetëm para gjykatës dhe autoriteteve tjera në juridiksionin e Palës së tyre, përveç në rast të ndonjë veprimi në lidhje me ndonjë aktivitet profesional apo tregtar të anëtareve të tyre të familjes.

Procedurat penale kundër familjes së shoferit që janë pjesë e familjes së tij, do të kryhen vetëm para gjyqit dhe autoriteteve tjera nën juridiksionin e Palës së shoferit.

10. Automjeti i Zyrtarit Ndërlidhës do të pajiset me targa të barasvlershme me ato që iu jepen Delegacionit të BE-së / Zyrës së BE-së.

11. Staf i paraparë në bazë të këtyre dispozitave do të përbëhet nga një Zyrtar Ndërlidhës, një asistent dhe një shofer.

12. Zyrtari Ndërlidhës dhe stafi i tij, si dhe anëtarët e familjeve të tyre do të pajisen me letërmjofime të veçanta me titujt e tyre si dhe me një referencë të kësaj marrëveshje.

13. Në mungesë të Zyrtarit Ndërlidhës, asistenti do t'i kryej detyrat e tij. Njoftimi për mungesën e Zyrtarit Ndërlidhës do t'i dorëzohet palës përkatëse.

14. Të dyja Palët do të mbajnë kanale të hapura dhe të drejtpërdrejta të komunikimit me Zyrtarin përkatës Ndërlidhës.

15. Të dyja Palët do të sigurojnë që të gjitha kushtet e nevojshme praktike dhe administrative të jenë të plotësuara në mënyre që t'i mundësojnë Zyrtarit Ndërlidhës dhe stafit të tij që t'i kryejnë detyrat e tyre.

16. Me kërkesë të njëres Palë, këto kushte do të rishikohen dhe mundësisht të ndryshohen me pëlqimin e ndërsjellë.

17. Këto kushte do të zbatohen përmes legjislacionit të secilës Palë përkatëse. Secila palë mund të paraqesë një shënim shpjegues për këtë qëllim.

Bruksel 31 maj 2013

**LIGJI NR. 04/L-199  
PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË PARË NDËRKOMBËTARE TË PARIMEVE QË  
RREGULLOJNË NORMALIZIMIN E MARRËDHËNIEVE MES REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE  
REPUBLIKËS SË SERBISË**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË PARË NDËRKOMBËTARE TË PARIMEVE QË  
RREGULLOJNË NORMALIZIMIN E MARRËDHËNIEVE MES REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE  
REPUBLIKËS SË SERBISË**

**Neni 1  
Qëllimi**

Ky ligj ratifikon Marrëveshjen e parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, parafuar më 19 prill 2013 nga Kryeministri i Republikës së Kosovës dhe Kryeministri i Republikës së Serbisë, miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 22 prill 2013, Vendimi Nr. 01/126, dhe nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 22 prill 2013, Rezoluta Nr. 04-R-10.

**Neni 2  
Fushëveprimi**

Fushëveprimi i këtij ligji është Marrëveshja e parë ndërkombëtare e parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, dhe kjo Marrëveshje është pjesë përbërëse e këtij ligji. Ky ligj do të zbatohet nga Republika e Kosovës, me ndihmën e Bashkimit Evropian, (BE), Forcave të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut në Kosovë, (KFOR), dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE).

**Neni 3  
Hyrja në Fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë pas shpalljes së tij nga Presidentja e Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/ L-199  
27 qershor 2013**

**Shpallur me dekretin Nr. DL-050-2013, datë 12.09.2013 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga**

\* LIGJI NR. 04/L-199 është i përfshirë në këtë botim ashtu siç është i publikuar në GAZETËN ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 38 / 17 SHTATOR 2013, PRISHTINË.  
Plani i zbatimit të Marrëveshjes nuk është i përfshirë në GAZETËN ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS.

### **Marrëveshja e Parë e Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve**

1. Do të krijohet një Asociacion/Bashkësi e komunave me shumicë serbe në Kosovë. Anëtarësimi do të jetë i hapur për çdo komunë tjetër me kusht që anëtarët janë në pajtim.
2. Bashkësia/Asociacioni do të krijohet përmes statutit. Shpërbërja e Bashkësisë/ Asociacionit mund të bëhet vetëm me vendim të komunave pjesëmarrëse. Do të ofrohen garanci ligjore përmes ligjit të zbatueshëm dhe të drejtës kushtetuese (përfshirë rregullën për shumicën prej 2/3).
3. Struktura e Asociacionit/Bashkësisë do të themelohet mbi të njëjtën bazë sikurse statuti ekzistues i Asociacionit të komunave të Kosovës, p.sh. Kryetari, Nënkryetari, Kuvendi, Këshilli.
4. Në përputhje me kompetencat e parapara me Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale dhe ligjin e Kosovës komunat pjesëmarrëse do të kenë të drejtë të bashkëpunojnë në ushtrimin e kompetencave të tyre përmes Asociacionit/Bashkësisë në mënyrë kolektive. Asociacioni/Bashkësia do të ketë mbikëqyrje të plotë mbi fushat e zhvillimit ekonomik, arsimin, shëndetësisë, planifikimit urban dhe rural.
5. Asociacioni/Bashkësia do të ushtroj kompetenca të tjera shtesë siç mund të delegohen nga autoritetet qendrore.
6. Bashkësia/Asociacioni do të ketë rol përfaqësues të autoritetet qendrore dhe do të ketë një ulëse në Këshillin Konsultativ të Komuniteteve për këtë qëllim. Në përmbushje të këtij roli është paraparë funksioni monitorues.
7. Në Kosovë do të ketë një forcë policore, e quajtur Policia e Kosovës. E tërë policia në Kosovën veriore do të integrohen në kornizën e Policisë së Kosovës. Pagat do të jenë vetëm nga PK-ja.
8. Pjesëtareve të strukturave tjera serbe të sigurisë do t'u ofrohet vend në strukturat ekuivalente të Kosovës.
9. Do të ketë një Komandant Rajonal të Policisë për katër komunat veriore me shumicë serbe (Mitrovica Veriore, Zveçani, Zubin Potoku dhe Leposaviqi). Komandanti i këtij rajoni do të jetë një serb i Kosovës i nominuar nga Ministria e Punëve të Brendshme nga lista e ofruar nga katër kryetarët e komunave në emër të Bashkësisë/Asociacionit. Përbërja e PK-së në veri do të reflektojë përbërjen etnike të popullatës së katër komunave. (Do të ketë Komandant tjetër rajonal për komunat e Mitrovicës Jugore, Skënderajit dhe Vushtrrisë). Komandanti rajonal i katër komunave veriore do të bashkëpunojë me komandantë tjerë rajonal.
10. Autoritetet gjyqësore do të integrohen dhe do të veprojnë në kuadër të kornizës ligjore të Kosovës. Gjykata e Apelit në Prishtinë do të themeloj një panel i përbërë nga një shumicë e gjykatësve serb të Kosovës për t'u marrë me të gjitha komunat e Kosovës me shumicë serbe. Një divizion i kësaj Gjykate të Apelit, i përbërë nga staf administrativ dhe gjyqtarë, do të vendoset në mënyrë të përhershme në Mitrovicën veriore (në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës). Secili panel i divizionit të mesipërm do të përbëhet nga një shumicë e gjyqtarëve serb të Kosovës. Gjyqtarët përkatës do të vendosen varësisht nga natyra e rastit në fjalë.
11. Zgjedhjet lokale në komunat e veriut do të organizohen në vitin 2013, me lehtësimin e OSBE-së, në përputhje me ligjin e Kosovës, dhe me standardet ndërkombëtare.
12. Një plan zbatimi, përfshirë afatin kohor, do të nxirret deri më 26 Prill. Parimi i financimit transparent do të adresohet në zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

13. Diskutimet lidhur me Energjinë dhe Telekomun do të intensifikohen nga të dy palët, dhe do të përfundojnë deri më 15 qershor.

14. Është arritur pajtimi që asnjëra palë nuk do të bllokojë, apo inkurajojë të tjerët të bllokojnë, progresin e palës tjetër në rrugët përkatëse drejt BE-së.

15. Do të themelohet një komision zbatimi nga të dy palët, me lehtësimin e BE-së.

### Aranzhimet lidhur me Telekomunikacionin

1. Në kontekstin e dialogut të lehtësuar nga BE-ja, të dyja palët janë dakorduar që Kosovës do të i ndahet një kod telefonik 3-shifror nga ITU (Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikimeve - UNT) në përputhje me standardet dhe parimet dhe afatet kohore të ITU-së, të dyja palët ranë dakord se një modalitet i pranuar reciprokisht do të duhet gjetur në lidhje me këtë proces brenda tre muajve, me lehtësimin e BE-së sipas nevojës.

Qëllimi është që periudha e migrimit në lidhje me kodin telefonik duhet të përfundojë deri në Janar 2015. Pas kësaj date, ky kod telefonik nga ITU do të përdoret nga të gjithë operatorët në Kosovë. Operatorët e të dyja palëve do të reduktojnë kostot e thirrjeve lokale për qytetarët.

2. Rregullatorët e të dyja palëve do të pajtohen për marrëveshje teknike për harmonizimin e përdorimit të spektrit për GSM, dhe sinjaleve televizive, duke përfshirë transmetimet digjitale tokësore, me qëllim për të siguruar ofrimin e shërbimeve të papenguara reciprokisht të bazuar në parimet e ITU-së dhe shmangien e interferencave të dëmshme ndërmjet shërbimeve. Secila Palë zotohet të mos mbulojë kufirin/kufirin administrativ të palës tjetër në mënyrë të qëllimshme.

Rregullatorët gjithashtu do të inkurajojnë dhe të lehtësojnë procesin e interkoneksionit dhe marrëveshjes roving midis operatorëve mobil të të dyja palëve me synimin për të reduktuar kostot për qytetarët. Ata gjithashtu do të hyjnë në një proces të harmonizimit edhe për frekuencat digjitale.

3. Në telefoninë fikse, një licencë e plotë për shërbime të telefonisë fikse do të lëshohet një Kompanie të Re, degë kjo e një kompanie serbe, e regjistruar në përputhje me kornizën rregullatore të Kosovës.
4. Sa i përket telefonisë mobile, autoritetet e Kosovës do të lëshojnë një kompanie të re një autorizim të përkohshëm, sipas kornizës rregullatore të Kosovës, për operimet e tashme, të kufizuara në infrastrukturën aktuale në terren. Ky autorizim i përkohshëm nuk do të përfundojë para Janarit 2015.

Autorizimi i përkohshëm do të skadojë sapo autoritetet e Kosovës të lëshojnë një licencë të re të plotë, të pakufizuar, të telefonisë mobile, si rezultat i një tenderi / ankandi. Tenderi do të organizohet në përputhje me standardet e BE-së.

5. Megjithëse shërbimet postare nuk ishin pjesë e këtyre diskutimeve, të dyja palët bien dakord për ti diskutuar ato në një fazë të mëvonshme.
6. Një grup për implementim do të formohet, me lehtësimin e BE-së sipas nevojës, në mënyrë që të hartojë një plan të plotë të veprimit për zbatimin e Marrëveshjes. Pasi aranzhimet e mësipërme të ketë hyrë në fuqi, grupi për zbatim mund të diskutojë, me kërkesë të ndonjëres palë, çfarëdo çështjesh tjera që mund ndërlidhet me këto aranzhime. Procesi i zbatimit të plotë do të fillojë pas pranimit me shkrim të Planit të Veprimit.

## Marrëveshja e Brukselit për dizajnin e pikëkalimeve të përhershëm të IBM-së në mes të dy shteteve

IBM IG, 4 shtator 2014 - Konkluzionet përfundimtare të Kryetarit

1. Në kuadër të dialogut të lehtësuar nga BE-ja ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, palët u takuan për të diskutuar hapat e ardhshëm për zbatimin e Protokollit Teknik të IBM-së i dakorduar nga viti 2012.
2. Palët u morën vesh për projekt dizajnë për pikat e kalimit të përhershëm të IBM-së dhe i nënshkruan dokumentet përkatëse.
3. Palët janë pajtuar edhe për mënyrën e vazhdimit tutje siç është propozuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Zgjerimit:
  - Kontraktori (Safage) do të finalizojë FIDIC (Libri i verdhë) deri në fund të vitit 2014.
  - Pas përfundimit të librit të verdhë, kontrata për projektimin dhe ndërtimin do të shkojnë për tenderim.
  - Fondet përkatëse do të jepen nga IPA-të respektive, të cilat tashmë janë zotuar dhe do të ndahen zyrtarisht në muajin e ardhshëm.
  - UNOPS do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të fazës tjetër.
4. Palët do të njoftohen në kohën e duhur nga ana e KE (Drejtoria për Zgjerim) mbi progresin e arritur.



## 16 dhjetor 2014

### Konkluzionet per licencime doganore te importeve:

1. Mbledhja e të gjitha institucioneve dhe kompanive relevante te Kosovës të regjistruara në katër komunat veriore që kanë nevojë për licenca për import të mallrave të kontrolluara do të organizohet më 22 dhjetor 2014 nga ZAMV në mjediset e përshtatshme në Mitrovicën e Veriut. Takimi do të lejojë këto kompani të paraqesin një kërkesë për licencë.
2. Sa i përket konkluzioneve më 5 nëntor 2013, licencat do të lëshohen në përputhje me legjislacionin e Kosovës.
3. Sa i përket konkluzioneve me 17 janar 2013, kompanitë në katër komunat veriore të themeluara para asaj dite nuk kanë nevojë të paraqesin, gjatë aplikimit për licenca, dokumentacionin nga Administrata Tatimore e Kosovës (numrin fiskal, numrin e TVSH), numrin e regjistrimit, kartat e identitetit të Kosovës ose dëshmitë gjyqësore.
4. Kompanitë nga katër komunat veriore, të cilat nuk do të dorëzojnë aplikacionet për licencim për importimin e mallrave të kontrolluara para 31 dhjetor 2014 nuk do të jenë në gjendje të vazhdojnë importimin pas kësaj date, pa dokumentet e duhura të licencimit të lëshuara në përputhje me legjislacionin e Kosovës.
5. Kompanitë nga katër komunat veriore, të cilat dorëzojnë aplikacionet për licencim për importimin e mallrave të kontrolluara para 31 dhjetor 2014 do të jetë në gjendje të vazhdojnë importimin deri në një vendim përfundimtar të nxjerr nga institucioni përkatës i Kosovës dhe të njoftohet kompania.
6. Pala e Beogradit do të paraqes listat e tyre të barnave esenciale (për trajtim të brendshëm dhe të jashtëm të pacientëve ) të përdorura në institucionet publike shëndetësore deri më 22 dhjetor 2014.
7. Afati i fundit për licencimin e barnave të paraqitura nga pala e Beogradit do të zgjatet deri më 30 maj 2015. Licencimi do të bëhet në përputhje me legjislacionin e Kosovës. Për të siguruar që barnat të licencohen deri më 30 maj 2015, pala tjetër duhet të paraqesin të gjitha dokumentet sa më shpejt të jetë e mundur, duke përfshirë CPP, me kusht që forma e CPP është dakorduar në përputhje me doganat, dokumentet fito sanitare dhe veterinare.
8. Deri në 30 maj 2015, importi i këtyre barnave do të rregullohet nga regjimi i importeve humanitare të ofruara nga legjislacioni i Kosovës.

## Marrëveshjet për vizita zyrtare

- 1 Palët përkatëse do të njoftojnë palën tjetër rreth vizitave të zyrtarëve të tyre. Njoftimet do të bëhen sipas mënyrës në vijim:
  - Institucioni që bën kërkesën do të dërgoj njoftimin drejtpërdrejtë tek ZN-ja e palës se ku do të zhvillohet vizita, duke dërguar një kopje (cc) për ZN-në e palës kërkuese për vizitë. ZN-ja e cila ka pranuar njoftimin do ta konfirmojë menjëherë pranimin.
  - Nëse në afatin e caktuar (në varësi të kategorisë, si më poshtë) nuk ka përgjigje atëherë vizita konsiderohet e miratuar.
  - Nëse janë ngritur kundërshtime në lidhje me afatin e dhënë ato duhet t'i komunikohen direkt ZN-së së palës që ka dërguar njoftimin. BE-së (Delegacioni i BE-së në Beograd ashtu dhe zyra e PSBE-së në Prishtinë) do të përfshihen (cc) në komunikim dhe dotë krijohen lehtësira nëse ka nevojë.
- 2 Njoftimi është i nevojshëm për kategoritë e mëposhtme të zyrtarëve:
  - a.) Grupi i parë përbëhet nga presidenti, kryeministri, zëvendëskryeministrat, kryetari i kuvendit dhe ministrat e punëve të brendshme, punëve të jashtme dhe të mbrojtjes. Për këtë kategori, njoftimi duhet të bëhet të paktën 72 orë përpara dhe çdo vërejtje duhet të ngrihet brenda 48 orëve të para.
  - b.) Grupi i dytë përbëhet nga të gjitha ministrat tjerë, nënkryetarët e kuvendit, drejtorët e zyrave qeveritare dhe agjencive të ndërlidhura me siguri, kryetarët e gjykatave kushtetuese dhe supreme, prokurori i shtetit si dhe të gjithë personat tjerë, të tillë si udhëheqësit fetarë që janë nën regjimin e mbrojtjes së afërt. Për këtë kategori njoftimi duhet të bëhet të paktën 48 orë përpara dhe çdo vërejtje duhet të ngrihet brenda 24 orëve të para.
- 3 Afatet rrjedhin pavarësisht ditëve të punës dhe ditëve që nuk punohet, por njoftimet duhet të dërgohen gjatë orarit të punës (E hëne -E premte deri në ora 5 pasdite).
- 4 Në rast emergjence që kërkon udhëtim të menjëhershëm, të dy ZN-të mund të bien dakordohennë mënyrë adhoc
- 5 Të gjitha ndryshimet e mundshme në programet e vizitave duhet të bëhen të paktën 24 orë para vizitës. Në rastin e vonesave të vogla gjatë vizitës, do të tregohet një fleksibilitet nga pala pritëse.
- 6 Zbatimi i pikave të lartpërmendura do të vlerësohet dhe nëse është e nevojshme do të rishikohet pas 3 muajsh me kërkesën e njëjës apo dy palëve.
- 7 Këto marrëveshje do të zbatohen që nga 1 dhjetor i vitit 2014.



**Republika e Kosovës**  
 Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria-Vlada-Government*

**MINISTRIA PËR DIALOG**

<b>DATE/A:</b>	09 shtator 2015
<b>REFERENCE-Ë:</b>	154
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Znj. Hykmete Bajrami Ministre e Tregtisë dhe Industrisë
<b>PËR DIJENI/PRIMER/CC:</b>	z. Isa Mustafa, Kryeministër z. Blerand Stavileci, Ministër i Zhvillimit Ekonomik z. Naim Bejtullahu Kryeshef, KOSTT z. Gazmend Mejjini, Kryeshef, ARBK z. Fitim Krasniqi, Sekretar i përgjithshëm i ZKM z. Valon Murtezaj, Këshilltar politik i Kryeministrit i angazhuar në Dialogun e Brukselit
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Edita Tahiri, Ministre për Dialogun
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Letër udhëzimi për regjistrimin e dy kompanive të reja konform Marrëveshjes së Brukselit për Energjinë

E nderuar znj. Bajrami,

Duke u bazuar në Marrëveshjen e Brukselit për çështjet e energjisë të nënshkruar më 8 Shtator 2013, Planin për zbatim me 18 shtator 2014 dhe Konkluzionet për implementim të nënshkruar më 25 gusht 2015, kemi hyrë në fazën e zbatimit të kësaj Marrëveshje e cila është në pajtim të plotë me ligjet dhe kornizën rregullatore të Republikës së Kosovës. Kjo Marrëveshje në pikat 3, 4 dhe 5 parasheh regjistrimin e dy kompanive të reja tek Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Çështja e regjistrimit të këtyre dy kompanive të reja është më e veçantë sepse duhet të regjistrohen në bazë të ligjeve të Kosovës si dhe të merren parasysh kufizimet në fushëveprimtarinë e tyre ashtu siç përcaktohen në Marrëveshjen për energjinë (pikat 3, 4 dhe 5).

Me qëllim të regjistrimit të drejtë të këtyre dy kompanive të reja nga ana e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë gjegjësisht Agjencionit për Regjistrimin Bizneseve po ju paraqes udhëzimet e nevojshme që ndërlidhen me Marrëveshjen e Brukselit për Energjinë. Udhëzimet i referohen gjithë procesit të regjistrimit, ku përfshihen baza ligjore, dokumentacioni për aplikim, vendimi për regjistrim dhe referenca e kodeve ekonomike për kufizimin e fushëveprimtarisë të këtyre kompanive të reja.

Në vijim po ju paraqes udhëzimet kryesore për këtë çështje:

## I. BAZA LIGJORE:

1. Marrëveshja për Energjinë e nënshkruar në mes të Republikës së Kosovës, Republikës së Serbisë dhe Bashkimit Evropian në Bruksel më datë 8 Shtator 2013
2. Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 11 shtator 2013 për Aprovimin e Marrëveshjes për Energjinë
3. Ligji nr. 04/I-199 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Parë Ndërkombëtare të Parimeve që rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë të shpallur më datë 17 shtator 2013 dhe

## II. VENDIMI PËR REGJISTRIM

Vendimi për regjistrim duhet të përmbajë këto elemente: pikat e marrëveshjes që lidhen me regjistrimin dhe fushë veprimtarinë e kufizuar të këtyre dy kompanive, interpretimin zyrtar të kësaj Marrëveshje si dhe kodet e sakta që i referohen këtyre fushë veprimtarive.

### 1. Pikat e Marrëveshjes që lidhen me regjistrimin dhe fushë veprimtarinë e kufizuar të këtyre dy kompanive të reja:

Pika 3. Autoritetet rregullative të të dyja palëve, me rastin e aplikimit, pa vonesë dhe në përputhje me kërkesat e kornizës ekzistuese të licencimit në juridiksionin e tyre, lëshojnë licenca që mbulojnë tregtinë (importin, eksportin, transitin) dhe furnizimin në KEK, KEDS dhe EPS, përkatësisht.

Pika 4. Të dyja palët do të përshpejtojnë procesin e hapjes së tregut deri më 1 korrik 2014, në përputhje me kalendarin e përcaktuar nga Traktati i Komunitetit të Energjisë, duke lejuar kështu themelimin e një kompanie të re të energjisë elektrike që t'i furnizojë konsumatorët. Të dyja palët gjithashtu janë dakorduar që kompania e tillë do të themelohet në bazë të kuadrit ligjor dhe rregullator të Kosovës.

Pika 5. Kjo kompani e re do të furnizojë me energji dhe mund të ofroj shërbime të distribuimit (siç janë faturimi, inkasimi, mirëmbajtja dhe lidhja fizike konsumatorët të rinj) për konsumatorët në katër komunat me shumicë serbe të pjesës veriore dhe mund ta ketë mundësinë që të blejë dhe shes energji në tregun e hapur.

### 2. Interpretimi zyrtar i Marrëveshjes për kufizimet e fushë veprimtarisë së kompanive të reja

Në përputhje dhe mbështetje të kornizës ligjore dhe rregullatore të Kosovës dhe duke iu referuar Marrëveshjes për Energjinë, këto dy kompani të reja mund të ofrojnë shërbime të energjisë përkatëse për:

- Tregti me energji elektrike (pika 3 e Marrëveshjes)
- Furnizim dhe shërbime distribuive (pika 4 dhe 5 e Marrëveshjes)

Aktivitetet biznesore që referohen në aplikacion nuk nënkuptojnë:

1. Operimin e sistemit të distribucionit për qëllim të dhënies çasjes ndonjë operatori i furnizimit për qëllim të livrimit të energjisë elektrike konsumatorëve të vet të kontraktuar;
2. Nuk nënkupton zhvillimin e sistemit të distribucionit me qëllim të krijimit të kushteve teknike në sigurimin e çasjes së palës së tretë për të zhvilluar biznesin e furnizimit me energji elektrike.

### 3. Referenca përkatëse nga kodet ekonomike për regjistrim të bizneseve

Referencat përkatëse nga kodet ekonomike duhet të reflektojnë saktësisht fushë veprimtarinë e kufizuar të këtyre dy kompanive të reja:

**Për kompaninë për tregti:**

Kodi : 3514 Tregtia e energjisë elektrike

**Për kompaninë për furnizim dhe shërbime distribuive**

3514 Tregtia e energjisë elektrike

3314Riparimi i pajisjeve elektrike

## III. DOKUMENTACIONI PËR APLIKIM

Nga Kryeshefi i ARBK z. Mejzini të datës 7 Shtator 2015 jemi njoftuar se përfaqësuesit e autorizuar për regjistrimin e dy kompanive “EPS Trgovina” sh.p.k dhe “Eletrosever” sh.p.k kanë dorëzuar aplikacionet dhe dokumentet tjera përcjellëse për regjistrimin e këtyre kompanive tek Agjencioni për Regjistrim të Bizneseve në MTI më 4 Shtator 2015 me numër të aplikimit 38A 000052 dhe 38A 000053.

Pas shqyrtimit të këtyre dokumentacioneve për aplikim nga këndi i Marrëveshjes së Brukselit për Energjinë nga ana e Grupit punues ku bënë pjesë edhe z. Mejzini kemi konstatuar me sa vijon: Dokumentacioni në fjalë përmban parregullsi të papranueshme ligjërishit dhe politikisht si dhe nuk janë në përputhje me frymë dhe parimet e dialogut të Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve mes dy shteteve.

Andaj ju njoftoj se nga aplikuesit duhet të kërkohet që këto dy dokumentacione të jenë në pajtim me ligjet e Republikës së Kosovës dhe fushë veprimtaria e këtyre dy kompanive të reja të jetë e kufizuar ashtu siç e përcakton Marrëveshja e Brukselit për çështjen e energjisë.

Më konkretisht korrjigjimet që duhet të bëhen në vijim:

#### **Kompania e re "Elektrosever"**

1. Aplikacioni/ fletëparaqitja për regjistrim për kompaninë "Elektrosever" D.O.O
  - Të ndryshohet emri i Kompanisë, të jetë vetëm emri "Elektrosever" D.O.O., ndërsa nëse kërkohet përshkrimi atëherë të hiqet formulimi "Usluge Snabdevanje i Dsitribucije Elektro Energije Privredno Drustvo za usluge snabdevanje i Distribucije elektro energije" dhe të zëvendësohet me " furnizim dhe shërbime distribuive " ( snabdevanje i distribucione usluge). Tek pjesa e shërbimeve distribuive duhet cekur se shërbimet distribuive janë: faturimi, inkasimi, mirëmbajtja dhe lidhja fizike për konsumatorët të rinj . (Duke iu referuar pikës 5 së Marrëveshjes për energjinë)
  - Kodet e veprimtarisë së kësaj kompanie të jenë në pajtim me kufizimet që janë përcaktuar nga Marrëveshja e Brukselit për energjinë. (3514 dhe 3314)
2. Vendimi për themelimin e kompanisë "Elektrosever" D.O.O
  - Ne preambulë të përfshihet Marrëveshja e parë për normalizimin e marrëdhënieve dhe Marrëveshja e Brukselit për energjinë të datës 8 Shtator 2013
  - Të riformulohet neni i parë i këtij vendimi. Ky nen duhet të thotë " Me këtë vendim miratohet themelimi i një kompanie të re për furnizim dhe shërbime distribuive në Kosovë me emrin e biznesit "Elektrosever" D.O.O me seli në Mtrovicën veriore" ( tani e tutje: kompania e re)
3. Te statuti duhet të bëhen ndryshime sipas ligjeve të Kosovës dhe kodeve të veprimtarisë sipas marrëveshjes së Brukselit. Preambula e statutit duhet të thirret në ligjet përkatëse të Kosovës. Adresa e kompanisë duhet të përfshi shtetin ku vepron, nuk mjafton vetëm emri i qytetit sepse është me paragjykimë politike. Dhe të tjera ndryshime sipas ligjit për shoqëritë tregtare të Kosovës.
4. Kudo tjetër që në këto dy dokumentacione mund të identifikohen formulime apo terme politikisht provokative dhe ligjërisht jo të sakta të hiqen dhe zëvendësohen me të tilla që janë konform ligjeve të Kosovës dhe Marrëveshjes së Brukselit.

### **Kompania e re "EPS Trgovina"**

1. Aplikacioni/ fletëparaqitja për regjistrim për kompaninë "EPS Trgovina" D.O.O  
- Të ndryshohet emri i Kompanisë, të jetë vetëm emri "EPS Trgovina" D.O.O, ndërsa nëse kërkohet përshkrimi atëherë të mbetet formulimi që e ka bërë aplikuesi.  
  
- Kodet e veprimtarisë së kësaj kompanie të jenë në pajtim me kufizimet që janë përcaktuar nga Marrëveshja e Brukselit për energjinë. (3514)
2. Vendimi për themelimin e kompanisë "EPS Trgovina" D.O.O  
-Ne preambulë të përfshihet Marrëveshja e parë për normalizimin e marrëdhënieve dhe Marrëveshja e Brukselit për energjinë të datës 8 Shtator 2013  
- Të riformulohet neni i parë i këtij vendimi. Ky nen duhet të thotë " Me këtë vendim miratohet themelimi i një kompanie të re për tregti të energjisë elektrike në Kosovë me emrin e biznesit "EPS Trgovina" D.O.O me seli në Mitrovicën veriore" ( tani e tutje: kompania e re)
3. Te statuti duhet të bëhen ndryshime sipas ligjeve të Kosovës dhe kodeve të veprimtarisë sipas marrëveshjes së Brukselit. Preambula e statutit duhet të thirret në ligjet përkatëse të Kosovës. Adresa e kompanisë duhet të përfshihet në ku vepron, nuk mjafton vetëm emri i qytetit sepse është me paragjykimet politike. Dhe të tjera ndryshime sipas ligjit për shoqëritë tregtare të Kosovës.
4. Kudo tjetër që në këto dy dokumentacione mund të identifikohen formulime apo terme politikiht provokative dhe ligjërisht jo të sakta të hiqen dhe zëvendësohen me të tilla që janë konform ligjeve të Kosovës dhe Marrëveshjes së Brukselit.

Të bashkangjitur me këtë letër po ju dërgojmë edhe dokumentacionin e plotë në lidhje me bazën ligjore të theksuar në pikën e parë të kësaj letre.

Ju falënderoj për bashkëpunimin dhe kontributin e dhënë për këtë çështje në kuadër të Dialogut të Brukselit.

Me respekt,



Edita Tahiri  
Ministre për Dialog  
Kryenegociatore për implementim në dialogun e Brukselit



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria-Vlada-Government*

MINISTRIA PËR DIALOG

DATE/A:	09 shtator 2015
REFERENCE-Ë:	Nr.ref. 153
PËR/ZA/TO:	Znj. Hykmete Bajrami Ministre e Tregtisë dhe Industrisë
PËR DIJENI/PRIMER/CC:	z. Isa Mustafa, Kryeministër z. Blerand Stavileci, Ministër i Zhvillimit Ekonomik z. Ekrem Hoxha, Kryeshef, ARKEP z. Gazmend Mejzini, Kryeshef, ARBK z. Fitim Krasniqi, Sekretar i përgjithshëm i ZKM z. Valon Murtezaj, Këshilltar politik i Kryeministrit i angazhuar në Dialogun e Brukselit
NGA/OD/FROM:	Edita Tahiri, Ministre për Dialog
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Letër udhëzimi për regjistrimin e kompanisë së re sipas Marrëveshjes së Brukselit për Telekomunikacion

E nderuar ministre Bajrami,

Duke marrë për bazë Marrëveshjen e Brukselit për çështjet e telekomunikacionit të nënshkruar më 8 shtator 2013 dhe pas nënshkrimit të Planit për Zbatim me 25 gusht 2015, kemi hyrë në fazën e zbatimit të kësaj Marrëveshje e cila është në pajtim të plotë me ligjet dhe kornizën rregullatore të Republikës së Kosovës. Kjo Marrëveshje në pikat 3 dhe 4 parasheh regjistrimin e një kompanie të re tek Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Çështja e regjistrimit të kësaj kompanie të re është më e veçantë sepse duhet të regjistrohet në bazë të ligjeve të Kosovës si dhe të merren parasysh kufizimet në fushëveprimtarinë saj ashtu siç përcaktohen në Marrëveshjen për telekomunikacionin (pikat 3 dhe 4).

Me qëllim të regjistrimit të drejtë kësaj kompanie të re nga ana e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë gjegjësisht Agjencionit për Regjistrimin Bizneseve po ju paraqes udhëzimet e nevojshme që ndërlidhen me Marrëveshjen e Brukselit për Telekomunikacion. Udhëzimet i referohen gjithë procesit të regjistrimit, ku përfshihen baza ligjore, dokumentacioni për aplikim, vendimi për regjistrim dhe referenca e kodeve ekonomike për kufizimin e fushëveprimtarisë së kësaj kompanie të re.

Në vijim po ju paraqes udhëzimet kryesore për këtë çështje:



## I. BAZA LIGJORE

Në kuadër të bazës ligjore, krahas ligjeve përkatëse për regjistrimin e kompanive në Republikën e Kosovës, duhet të përfshihen edhe

1. Marrëveshja për Telekomunikacionin e nënshkruar në mes të Republikës së Kosovës, Republikës së Serbisë dhe Bashkimit Evropian në Bruksel më datë 8 Shtator 2013
2. Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës i datës 11 Shtator 2013 për miratimin e Marrëveshjes për Telekomunikacionin
3. Ligji nr. 04/L-199 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Parë Ndërkombëtare të Parimeve që rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë të shpallur më datë 17 shtator 2013

## II. VENDIMI PËR REGJISTRIM

Vendimi për regjistrim duhet të përmbaj këto elemente: pikat e marrëveshjes që lidhen me regjistrimin dhe fushë veprimtarinë e kufizuar të kompanisë së re, interpretimin zyrtar të kësaj Marrëveshje si dhe kodet e sakta që i referohen kësaj fushë veprimtarie.

### 1. Pikat e Marrëveshjes që lidhen me regjistrimin dhe fushë veprimtarinë e kufizuar të kompanisë së re

Pika 3: Në telefoninë fikse, një licencë e plotë për shërbime të telefonisë fikse do të lëshohet një Kompanie të Re, degë ljo e një kompanie serbe, e regjistruar në përputhje me kornizën rregullatore të Kosovës.

Pika 4. Sa i përket telefonisë mobile, autoritetet e Kosovës do të lëshojnë një kompanie të re një autorizim të përkohshëm, sipas kornizës rregullatore të Kosovës, për operimet e tashme të kufizuara në infrastrukturën aktuale në terren. Ky autorizim i përkohshëm nuk do të përfundojë para Janarit 2015.

Autorizimi i përkohshëm do të skadojë sapo autoritetet e Kosovës të lëshojnë një licencë të re të plotë, të pakufizuar, të telefonisë mobile, si rezultat i një tenderi / ankandi. Tenderi do të organizohet në përputhje me standardet e BE-së.

## 2. Interpretimi zyrtar i Marrëveshjes për kufizimet e fushë veprimtarisë së kompanisë së re

Në përputhje dhe mbështetje të kornizës ligjore dhe rregullatore të Kosovës dhe referim të Marrëveshjes për Telekomunikacionit të Shtatorit 2013, Kompania e re mund të ofroj shërbimet dhe pajiset me autorizimet përkatëse për:

- Telefonisë Fikse (Pika 3 e Marrëveshjes)
- Telefonisë Mobile me operime të kufizuara dhe validitet të përkohshëm sipas kushteve dhe autorizimeve të dhëna nga Autoriteti Rregullator ARKEP (Pika 4 e Marrëveshjes)
- Në bazë të Marrëveshjes, kjo nuk është një operator i tretë i telefonisë mobile në Kosovë, sepse në bazë të ligjeve të Kosovës për një operator të tillë duhet një tender ndërkombëtar.

## 3. Referenca përkatëse nga kodet ekonomike për regjistrim të bizneseve

Referencat përkatëse nga kodet ekonomike duhet të reflektojnë saktësisht fushë veprimtarinë e kufizuar të kompanisë së re. Këto kode janë:

### Aktiviteti kryesor i biznesit

6110 - Veprimtaritë e Telekomunikimit kabllor

### Aktiviteti sekondar

6120 - Aktivitete të Telekomunikimit pa tela (*wireless*)

### Aktivitetet tjera

6190 - Veprimtaritë e tjera të telekomunikimit

6130 - Veprimtaritë e telekomunikimit satelitor

6312 - Web portalet (internet portalet)

4222 - Ndërtimi i projekteve të shërbimeve publike për energji elektrike dhe telekomunikime

4329 - Instalime të tjera ndërtimore

4619 - Veprimtaritë e ndërmjetësimit për shitjen e një shumëllojshmërie mallërash

4742 - Tregtia me pakicë e pajisjeve të telekomunikimit në dyqane të specializuara

4719 - Tregti tjetër me pakicë në dyqane jo të specializuara

### 3. DOKUMENTACIONI PËR APLIKIM

Në letren tuaj të datës 03 shtator 2015 keni njoftuar se më 02 shtator 2015 përfaqësuesi i autorizuar i kompanisë së re mts sh.p.k ka dorëzuar aplikacionin dhe dokumentete tjera përcjellëse për regjistrimin e kësaj kompanie tek Agjencia për Regjistrimin e Biznesit në MTI me numër aplikimi 38A 000051. Po ashtu në këtë letër keni ngritur shqetësimet për parregullsitë e evidentuara në këtë dokumentacion.

Pas shqyrtimit të këtij dokumentacioni për aplikim në kontekstin e Marrëveshjes së Brukselit për Telekomunikacion e cila bazohet në ligjet e Kosovës dhe të shqetësimeve të bazuara të ngritura në letren tuaj, vlerësoj se një dokumentacion i tillë është i papranueshëm ligjërisht dhe politikisht si dhe i njëjti nuk është në përputhje me frymën dhe parimet e dialogut të Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve mes dy shteteve.

Ju bëjë me dije se duhet të kërkohet nga aplikuesi që dokumentacioni në fjalë të jetë në pajtim me ligjet e Kosovës dhe fushëveprimtarinë e kompanisë së re duhet të jetë e kufizuar ashtu siç e përcakton Marrëveshja e Brukselit për telekomunikacion.

Më konkretisht korrigjimet që duhet të bëhen si në vijim:

#### 1. Aplikacioni/ fletëparaqitja për regjistrim

- të hiqet termi " Mitrovica e Kosovës" dhe të zëvendësohet me "Mitrovica veriore" në gjithë dokumentacionin.

-kodet e veprimtarisë së kësaj kompanie të jenë në pajtim me kufizimet që janë përcaktuar nga Marrëveshja e Brukselit për telekomunikacion, sipas pikës II. 3 të kësaj letre.

- data e miratimit të statutit duhet të jetë pas datës 25 gusht 2015 kur është nënshkruar Plani për zbatim.

#### 2. Vendimi për themelimin e kompanisë

- në preambulë të përfshihet Marrëveshja e Brukselit për telekomunikacion e datës 8 shtator 2013

- të riformulohet neni i parë i këtij vendimi. Ky nen duhet të thotë " Me këtë vendim miratohet themelimi i një kompanie të re si degë e Telekom Serbia sh.a. të regjistrohet në Kosovë me emrin e biznesit 'mts.d.o.o' me seli në Mitrovicën veriore", Kosovë ( tani e tutje: kompania e re)

- data e vendimit duhet të jetë pas datës 25 gusht 2015 kur është nënshkruar Plani për zbatim.

3. Kudo tjetër në këtë dokumentacion që mund të identifikohen formulime apo terme politikisht provokative dhe ligjërisht jo të sakta si "Kosove dhe Metohi", " territori i Kosovës dhe Metohisë" duhet të hiqen dhe zëvendësohen me termin "Kosovë" në pajtim me Marrëveshjet e Brukselit.

4. Te statuti duhet të bëhen ndryshime sipas ligjeve të Kosovës dhe kodeve të veprimtarisë sipas marrëveshjes së Brukselit. Preambula e statutit duhet të thirret në ligjet përkatëse të Kosovës sepse në dokument përmendet vetëm numri i ligjit por jo edhe shtetit ku i përket. Adresa e kompanisë duhet të përfshi shtetin ku vepron, nuk mjafton vetëm emri i qytetit sepse është me paragjykimë politike. Dhe të tjera ndryshime sipas ligjit për shoqëritë tregtare të Kosovës.

Të bashkangjitur me këtë letër po ju dërgojmë dhe dokumentacionin e plotë në lidhje me bazën ligjore të theksuar në pikën e parë të kësaj letre.

Ju falënderoj për bashkëpunimin dhe kontributin e dhënë për këtë çështje në kuadër të Dialogut të Brukselit.

Me respekt,



Edita Tahiri  
Ministre për Dialog  
Kryenegociatore në dialogun teknik të Brukselit

## Procesi i Integritit

### I. Integrimi i stafit të Mbrojtjes Civile (MC)

Procesi i integritit të individëve do të jetë në përputhshmëri me marrëveshjen e Brukselit dhe ligjeve të Kosovës për shërbyesit civil

1. Pala e Beogradit ka dorëzuar një listë prej 751 anëtarëve të MC-së për tu integruar në institucionet e Kosovës.
2. Pala e Prishtinës në total ka ofruar 483 pozita për pjesën veriore, nga të cilat 80 në Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave dhe 25 në Shërbimin Korrektues të Kosovës; 50 pozita në fondet kontigjente, ku ata do të marrin paga por vendet e punës do të përcaktohet në sektorin publik brenda 3 viteve.
3. Pranueshmëria: Nga gjithsej 751 persona, vetëm ata që posedojnë dokument identifikimi valid të Kosovës ose vërtetim të aplikim për dokumentin e identifikimi nga Kosova, të cilët nuk janë ende në listën e pagave të ndonjërit nga institucionet e Kosovës dhe ata të cilët do ta kalojnë verifikimin e sigurisë do të jenë të pranueshëm për integrim.
4. Pas vlerësimit të përshtatshmërisë paneli do të bëjë përzgjedhjen e individëve për pozitat specifike duke u bazuar në interesimin e shprehur (më shumë se një opsion), edukimin e tyre dhe përvojës profesionale.
5. Në përgjithësi, paneli do të përbëhet nga 4 anëtarë. Dy anëtar nga institucionet e Kosovës, një përfaqësues nga ish-MC-ja; dhe një përfaqësues i BE-së. Ndërsa për pozitat që kanë të bëjnë me çështjet e trashëgimisë kulturore dhe fetare (20 në total) Kisha Ortodokse Serbe nga Kosova dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Kosovës do të konsultohen para përzgjedhjes përfundimtare. Më 8 prill 2015 emrat e anëtarëve të panelit do të përcjellën tek lehtësuesit e BE-së.
6. Paneli i lartpërmendur do të themelohet më 27 prill 2015, kur do të zhvillohet takimi i parë. Takimi i panelit do të mbahet në Prishtinë në lokalet që do të vendos pala e Prishtinës.
7. Paneli duhet ta përmbyll punën e tij jo më vonë se më 14 gusht 2015, dhe të gjitha kontratat e punës duhet të nënshkruhen deri më 15 shtator 2015, kur i gjithë procesi i integritit duhet të kryhet.
8. Paneli do të vendos për metodën e përzgjedhjes, duke përfshirë intervistat e mundshme me kandidatët e caktuar, nëse dhe kur është e nevojshme. Është obligim i kandidatëve dhe punëdhënësit të tyre aktual që të sigurojnë të gjitha informatat shtesë siç kërkohet nga paneli.
9. Paneli fillimisht do të vendosë në përzgjedhjen e kandidatëve në fushën e menaxhimit të emergjencave (80 pozita) dhe si punonjës të shërbimit korrektues (25 pozita). Përzgjedhja për këtyre pozitave duhet të kryhet më 15 qershor 2015 dhe nënshkrimi i kontratave më 1 korrik 2015.
10. Pas përzgjedhjes së kandidatëve dhe njoftimit me shkrim nga paneli, kandidatët do të kenë afat prej 15 ditëve që të nënshkruajnë kontratën e punës dhe deklaratën (drafti në aneks). Pala e Prishtinës do të bëjë çdo gjë që është e nevojshme për të përshpejtuar pajisjen me dokumente. Në rast se kandidati i përzgjedhur nuk e nënshkruan kontratën e punës dhe deklaratën 15 ditë pas marrjes së njoftimit nga paneli, ajo pozitë do t'i ofrohet personit tjetër dhe ky person do të largohet nga lista e të përgjegjshmeve për integrim. Në rastet kur kandidatët e përzgjedhur në periudhën mes 15 korrikut dhe 14 gushtit 2015 dështojnë në nënshkrimin e kontratës së punës dhe deklaratës, 30 ditë shtesë (deri më 15 shtator 2015) do t'i jepen panelit për përzgjedhjen e re dhe ofrimin të pozitave të paplotësuara tek kandidatët tjerë të pranueshëm.

11. Të gjitha pozitat e ofruara, do të përmbushen nga kandidatët e pranueshëm me ish-anëtarë të MC-së.

## II. Trajtimi i lokacioneve dhe pajisjeve të MC

12. Pala e Beogradit ka dorëzuar tek ndërmjetësit e BE-së një listë të vendndodhjes së lokacioneve dhe <<pikave të vëzhgimit>> aktualisht nën udhëheqjen e anëtarëve të MC-së.
13. Tri pikat e vëzhgimit në mes rrugës Mitrovicë - Jarinjë do të largohen nga rruga më 20 prill 2015, dhe pika vëzhguese e vendosur në pjesën veriore në Urën kryesore në Mitrovicë do t'i dorëzohet PK-së poashtu më 20 prill 2015. Procesi do të monitorohet dhe verifikohet nga PK-ja dhe EULEX.
14. Bazuar në listën e dorëzuar të lokacioneve, pala e Prishtinës do të bëjë vlerësimin se cila nga lokacionet mund të vazhdojnë të përdoren me qëllim të hapjes së institucioneve relevante të Kosovës, ku do të punojnë stafi i integruar. Është në përgjegjësinë e palës së Prishtinës që të ofrojnë, pajisin, dhe rinovojnë këto lokacione dhe të tjera të nevojshme më së voni deri më 1 Shtator 2015. Dorëzimi i këtyre lokacioneve do të fillojë kur paneli do të verifikojë tek ndërmjetësit e BE-së integrimin e plotë të 105 anëtarëve të MC-së. Procesi do të jetë gradual, do të përmbillet jo më vonë se më 20 korrik 2015.
15. Secila pikë vëzhgimi, duke përfshirë pajisjet teknike dhe qendrën e situatave, do të largohen apo dorëzohen tek PK-ja më 20 prill 2015.
16. Pala e Beogradit ka njoftuar se MC-ja i posedon rreth 500 xhaketa zyrtare. Pala e Beogradit në formë të shkruar do të informojë ndërmjetësit e BE-së për ndërprerjen e përdorimit të këtyre xhaketave zyrtare në ditën e integrit të 105 kandidatëve të përzgjedhur. Gjatë dhe pas integrit ish anëtarëve të MC-së nuk do të lejohen të mbahen të veshura më asnjë lloj uniformash apo veshje civile të ngjashme me simbolet e MC-së. Pas integrit, punëdhënësi do të vendos për kodin e veshjes, duke përfshirë edhe uniformat nëse dhe kur janë të përdorshme, varësisht nga institucioni ku individi do të integrohet.
17. Pala e Beogradit do të ofrojë një inventar të të gjitha pajisjeve që aktualisht janë në përdorim dhe zotim të MC-së tek ndërmjetësit e BE-së më 24 prill 2015. Pala e Prishtinës do të vendos nëse këto pajisje do të vazhdojnë të përdoren nga institucionet e Kosovës në komunat veriore, pajisjet e mbetura do të transferohen tek pala e Beogradit, të cilat do të verifikohen nga PK dhe EULEX.
18. Pala e Beogradit ka ofruar konfirmim me shkrim se MC-ja dhe anëtarët e saj nuk posedojnë asnjë armë zyrtare. Në rast se pala e Prishtinës do të ofrojë prova të besueshme se MC-ja posedon armë zyrtare do të njoftojë ndërmjetësit e BE-së, dhe EULEX-i dhe PK-ja së bashku do të fillojnë operacionet e kërkimit pa paralajmërim.

## III. Notifikimet:

19. Pala e Beogradit në formë të shkruar do të njoftojë ndërmjetësit e BE-së për ndërprerjen e pagave dhe ofrimit të ndonjë ndihme financiare për MC-në në Kosovë më 1 shtator 2015, përveç personave që përfshihen në pikën 10 deri më 15 shtator 2015, dhe do të miratoj rregulloret e brendshme të nevojshme për ta zbatuar këtë vendim. Një kopje e kësaj rregulloreje do të dorëzohet tek ndërmjetësit e BE-së më 1 shtator 2015.
20. Pala e Beogradit më 24 prill 2015 në formë të shkruar do të njoftojë ndërmjetësit e BE-së se MC-ja në Kosovë më nuk do të ekzistoj përbrenda sistemit të Serbisë nga 1 shtatori 2015.

## **Marrëveshja e Brukselit për njohjen reciproke të Certifikatave ADR**

### **Konkluzionet e kryesuesit të BE të datës 19 prill 2016**

1. Palët zotohen për lëvizjen e lirë të mallrave, duke përfshirë mallrat e rrezikshme, pa pengesa dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare / Evropiane.
2. Palët pajtohen që reciprokisht ti pranojnë të gjitha standardet ndërkombëtare / Evropiane për transportin / bartjen e mallrave të rrezikshme, përfshirë të gjithë dokumentacionin në përputhje me konventën e ADR-së (certifikatat e shoferëve dhe automjeteve).
3. Me këtë marrëveshje nuk preken detyrimet ndërkombëtare të secilës palë.
4. Kjo marrëveshje hynë në fuqi më 25 prill 2016.
5. Një grup për zbatim do të formohet nga BE që të monitorojë implementimin.

**Aranzhimet lidhur me finalizimin e zbatimit të marrëveshjes për lëvizjen e lirë të vitit 2011**

**Bruksel, 14 Shtator 2016**

1. Palët janë pajtuar që të mbulohen pjesët relevante të tabelave respektive të automjeteve me dy letër ngjitëse të bardha.
2. Ky sistem me letër ngjitëse do të hyjë në fuqi me 15 nëntor 2016.
3. Infrastruktura administrative për lëshimin e të gjitha dokumenteve të nevojshme për regjistrimin e automjeteve me tabela të lëshuara nga autoritetet e Kosovës do të hyjë në fuqi në nëntor 2016.
4. Regjistrimi i të gjitha automjeteve me tabelat e lëshuara nga autoritetet e Kosovës (KS/RKS) do të fillojë më 15 janar 2017 dhe do të zgjasë për 12 muaj, në fund të së cilës periudhë do të ketë vlerësim nga të dy palët me ndërmjetësimin e BE-së.
5. Kosova do të zgjasë validitetin e tabelave KS për pesë vite në fund të së cilës çështja do të shqyrtohet nga të dyja palët (me ndihmën e BE-së nëse është kërkoher).
6. Përjashtimet nga taksat dhe detyrimet për regjistrimin e automjeteve do të garantohet nga Kosova në të njëjtën mënyrë sikurse në rastin e kaluar. Bashkëpunim i ngushtë dhe i shpejtë do të vendoset në mes të dyja palëve për të verifikuar pronësinë e automjetit.
7. Një fushatë informuese për t'ua shpjeguar banorëve të afektuar modalitetet për ri-regjistrim të automjeteve do të ndërmerret nga të dy palët dhe BE-ja. Diskutimet e mëtejshme mbi fushëveprimin dhe modalitetet e fushatës së lartpërmendur do të diskutohen në grupin për zbatim.
8. Tabelat e veturave që preken nga procesi i regjistrimit nuk do të afektohen nga sistemi i letër ngjitëseve.
9. Për shkak të ndjeshmërisë ndërlidhur më pikat e lartpërmendura, palët janë pajtuar të vlerësojnë zbatimin e këtyre konkluzioneve në intervale të rregullta.



## Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore

### Korniza ligjore

1) Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë themelohet si një Asociacion/Bashkësi i komunave siç parashihet me Marrëveshjen e Parë, Ligjin mbi Ratifikimin e Marrëveshjes së Parë dhe ligjet e Kosovës.

2) Në bazë të Marrëveshjes së Parë, e cila njih karakterin e tij të veçantë, Qeveria e Kosovës do të miratojë një dekret të aplikueshëm drejtpërdrejtë, i cili do të shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese. Bashkësia/Asociacioni do të jetë entitet juridik, i definuar me Statutin e tij, që do të përmbajë së paku elementet e mëposhtme:

3) Statuti do të aprovohet nga kuvendi themelues të cilin e përbëjnë anëtarët e zgjedhur me vota nga radhët e kuvendeve të komunave pjesëmarrëse.

### Objektivat

4) Në përputhje me Marrëveshjen e Parë, objektivat kryesore të Asociacionit/Bashkësisë do të jenë ofrimi i funksioneve dhe shërbimeve publike për:

- a) fuqizimin e demokracisë lokale;
- b) ushtrimin e vështrimit të plotë për zhvillimin e ekonomisë lokale;
- c) ushtrimin e vështrimit të plotë në fushën e arsimit;
- d) ushtrimin e vështrimit të plotë për përmirësimin e shëndetësisë lokale primare e sekondare dhe përkuqjesjes sociale;
- e) ushtrimin e vështrimit të plotë për koordinimin e planifikimit urban dhe rural;
- g) aprovimin e masave për përmirësimin e kushteve lokale të jetesës për të kthyerit në Kosovë;
- h) zhvillimin, koordinimin, dhe lehtësimin e veprimtarive kërkimore dhe zhvillimore;
- i) promovimin, afirmimin, dhe avokimin e çështjeve me interes të përbashkët për anëtarët e tij dhe përfaqësimin e tyre, përfshirë tek autoritetet qendrore;
- j) ofrimin e shërbimeve për anëtarët e tij në përputhje me ligjet e Kosovës;

k) vlerësimin e ofrimit të shërbimeve publike për anëtarët e tij dhe për banorët e tyre me qëllim të përkrahjes së Bashkësisë/ Asociacionit për formësimin e qëndrimeve me interes të përbashkët lidhur me pjesëmarrjen në punën e autoriteteve qendrore;

l) monitorimin sipas nevojës të zbatimit të objektivave të tij;

m) vendosjen marrëdhënies dhe hyrjen në aranzhime bashkëpunimi me asociacionet tjera të komunave, vendore dhe ndërkombëtare.

5) Bashkësia/ Asociacioni do të ushtrojë edhe kompetenca tjera shtesë, të cilat mund t'i delegohen nga autoritetet qendrore.

### **Struktura organizative**

6) Asociacioni/ Bashkësia do t'i ketë këto organe:

a) Kuvendin, si trup më të lartë, të cilin e përbëjnë përfaqësuesit e emëruar nga kuvendet e komunave pjesëmarrëse, nga anëtarët e tyre të zgjedhur. Kuvendi do të ketë të drejtë të miratojë amendamentet e Statutit, rregulloren e punës dhe të gjitha rregulloret dhe udhëzimet tjera administrative në pajtim me Statutin dhe ndërlidhur me objektivat e tij.

Të gjitha amendamentet e Statutit, rregullorja e punës dhe të gjitha rregulloret e nevojshme si edhe vendimet të cilat i miraton Kuvendi do të jenë të zbatueshme për anëtarët e tij, përveç në rast se ndonjëri nga anëtarët paraqet formalisht vendim tjetër.

b) Kryetari, i cili do ta përfaqësojë Bashkësinë/ Asociacionin, përfshirë tek autoritetet qendrore dhe jashtë Kosovës. Kryetarin do ta ndihmojë nën-kryetari. Kryetarin dhe nën-kryetarin do t'i zgjedhë Kuvendi, nga radhët e anëtarëve të Kuvendeve Komunale pjesëmarrëse, dhe të kryetarëve të komunave.

c) Këshilli i përbërë nga më së shumti 30 anëtarë, banorë të komunave pjesëmarrëse, përfshirë të gjithë kryetarët e këtyre komunave; Këshilli është trup këshillëdhënës, i cili jep udhëzime për punën e Asociacionit/ Bashkësisë.

d) Bordi, i përbërë nga 7 anëtarë, të zgjedhur me votë nga Kuvend, nga radhët e kryetarëve dhe banorëve të komunave pjesëmarrëse, përbërja e saktë e të cilit do të definohet në Statut, do të ketë të drejtë të marrë vendime të nevojshme për menaxhimin ditor të Bashkësisë/ Asociacionit. Anëtarët e Bordit, gjatë punës së tyre, do të përkrahën nga kolegji me profesionale të përbëra nga ekspertë të fushave përkatëse që përkohë me objektivat dhe detyrat e Asociacionit/ Bashkësisë. Statuti do të definojë numrin e kolegji me profesionale dhe përgjegjësitë e tyre ndaj anëtarëve të Bordit.

e) Administrata, e udhëhequr nga Shefi i Administratës, i cili emërohet nga Bordi dhe i raporton Bordit, për të ndihmuar punën e Bashkësisë/ Asociacionit, në veçanti Bordit dhe Kryetarit. Staf i administratës do të përfitojë nga statusi i të punësuarve, në përputhje me ligjet e Kosovës, duke përfshirë Ligjin e Punës dhe Ligjin mbi Shërbimin Civil, të cilat ua mundësojnë të ushtrojnë detyrat e tyre administrative. Anëtarët e Asociacionit/Bashkësisë mund të vendosin të përdorin një numër të të punësuarve për të përkrahur Bashkësinë/ Asociacionin në përmbushjen e objektivave të tij.

f) Zyra e ankesave, me mandat që të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me objektivat e tij.

7) Selia e Bashkësisë/ Asociacionit do të përcaktohet me Statut.

#### **Marrëdhëniet me autoritetet qendrore**

8) Asociacioni/Bashkësia do të punojë me autoritetet qendrore sipas parimit të bashkëpunimit të ndërsjellë dhe shkëmbimit të informatave.

9) Asociacioni/Bashkësia do të promovojë interesat e komunitetit serb të Kosovës në raport me autoritet qendrore.

10) Asociacioni/Bashkësia do të ketë të drejtë të propozojë, në përputhje me ligjet e Kosovës, amendamentet e legjislacionit dhe rregulloreve tjera relevante për përmbushjen e objektivave të tij.

11) Asociacioni/Bashkësia do të ketë të drejtë të iniciojë apo të marrë pjesë në procedurat gjyqësore në gjykatat kompetente, përfshirë Gjykatën Kushtetuese, kundër çfarëdo akti apo vendimi të cilitdo institucion që ndikon në ushtrimin e kompetencave të Asociacionit/Bashkësisë, në përputhje me Statutin e tij.

12) Asociacioni/Bashkësia do të ketë të drejtë të nominojë përfaqësues në organet/trupat kompetente të qeverisë qendrore, përfshirë Këshillin Konsultativ për Komunitete. Me qëllim të përmbushjes së funksionit monitorues, të paraparë me Marrëveshjen e Parë, përfaqësuesi i Asociacionit/Bashkësisë do të ketë të drejtë të ketë qasje në informatat e autoritetet qendrore, në përputhje me ligjet e Kosovës.

13) Në emër të Asociacionit/Bashkësisë, katër kryetarët e komunave veriore do t'i ofrojnë Ministrisë së Brendshme një listë të kandidatëve për emërim si komandant i policisë rajonale, siç përcaktohet në Nenin 9 të Marrëveshjes së Parë.

#### **Kapaciteti ligjorë**

14) Asociacionit/Bashkësisë do ti ofrohet hapësira e nevojshme ligjore, sipas ligjeve të Kosovës, në mënyrë që të përmbushë objektivat e tij, përfshirë të drejtën e posedimit të pronës së luajtshme dhe të paluajtshme, të bashkëpronësisë së kompanive që ofrojnë shërbime lokale në kuadër të fushëveprimit të Asociacionit/Bashkësisë dhe të lidhë kontrata, përfshirë kontrata pune.

15) Në bazë të Marrëveshjes së Parë, Asociacioni/Bashkësia konsiderohet i themeluar, pas miratimit të dekretit, për përmbushjen e objektivat e tij.

#### **Buxheti dhe përkrahja**

16) Asociacioni/Bashkësia do ta ketë buxhetin e tij, i cili do të administrohet në përputhje me parimet e transparencës dhe llogaridhënies si dhe me dispozitat e Ligjit mbi Prokurimin Publik.

Këto parime posaçërisht do të vlejné për dedikimin e fondeve, përfshirë ato të përshkuara në pikën 17d.

Do të ketë auditim të shpenzimeve nga autoritetet kompetente, përfshirë Auditorin e Përgjithshëm.

17) Asociacioni/Bashkësia do të financohet nga:

a) kontributet e anëtarëve të tij;

b) të hyrat dhe të ardhurat nga shërbimet që i ofron Asociacioni/Bashkësia, kompanitë e tij, apo që do të burojnë nga asetet e tij të luajtshme dhe të paluajtshme;

c) transferet nga autoritet qendrore;

d) kontributet, grantet, donacionet si dhe përkrahja financiare e asocioneve dhe organizatave tjera, vendore dhe ndërkombëtare, si edhe nga Republika e Serbisë; Bashkësia/Asociacioni do të lirohet nga detyrimet dhe taksat për përmbushjen e objektivate të tij, sipas të njëjtit model me komunat pjesëmarrëse.

#### **Dispozitat e përgjithshme dhe përfundimtare**

18) Asociacioni/Bashkësia do të jetë i hapur për çdo komunë tjetër, me kusht që të pajtohen anëtarët e tij.

19) Asociacioni/Bashkësia mund të shpërbëhet vetëm me vendim të Kuvendit të tij, të miratuar me shumicë prej 2/3 e anëtarëve të tij.

20) Asociacioni/Bashkësia do të ketë të drejtë t'i ketë simbolet zyrtare të tij (stemën dhe flamurin), në përputhje me ligjet e Kosovës.

21) Statuti i Asociacionit/Bashkësisë do të hartohet nga Ekipi Menaxhues dhe do të prezantohet në Dialogun e Nivelit të Lartë, brenda 4 muajve nga data e arritjes së marrëveshjes për këto parime/elemente, sipas nevojës, me lehtësimin e Ministrisë së Qeverisjes Lokale. Statuti do të konfirmohet me dekret, pas marrëveshjes në Dialog. Secili amendament do të prezantohet nga Asociacioni/Bashkësia, do të konfirmohet me dekret dhe do të shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese.

22) Brenda një viti nga aprovimi i Statutit të Asociacionit/Bashkësisë do të bëhet shqyrtimi i implementimit të tij, përfshirë çështjet që burojnë nga Neni 5 i Marrëveshjes së Parë.

DIALOGU  
KOSOVË - SERBI

2020

*Botues:*

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

*Redaktor teknik:*

ASHAK

*Realizimi kompjuterik:*

ASHAK

*Madhësia:* 12 tabakë shtypi

*Tirazhi:* 200 copë

*Formati:* 23x28 cm

*Shtypi:*

---

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

94(496.51)

327(496.51:497.11)

Dialogu Kosovë-Serbi : (dilemat dhe kundërthëniet) / Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. - Prishtinë : Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2020. - 94 f. ; 28 cm.

ISBN 978-9951-26-021-3



ISBN 978-9951-26-021-3



9 789951 260213